

LIGJ PËR ARSIM FILLOR

I. DISPOZITA THEMELORE

Lënda e ligjit

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet procesi edukativo-arsimor i cili realizohet në shkolla fillore, si dhe veprimtaria e arsimit fillor si pjesë e sistemit unik edukativo-arsimor.

(2) Veprimtaria e arsimit fillor është me interes të veçantë publik.

Përdorimi i shprehjeve

Neni 2

Shprehjet të cilat në këtë ligj përdoren në gjininë mashkullore gramatikore janë neutrale dhe kanë të bëjnë me personat edhe të gjinisë mashkullore dhe femërore.

E drejta e arsimit fillor

Neni 3

(1) Çdo fëmijë ka të drejtë të edukimit dhe arsimit fillor falas dhe cilësor në shkollë fillore.

(2) Në arsimin fillor mund të përfshihen edhe persona të moshuar, në pajtim me Ligjin për arsimin e të moshuarve.

(3) Me propozim të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Byroja) dhe të Komisionit Shtetëror të Provimeve, ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri) miraton standarde për përcaktimin e cilësisë në arsimin fillor.

Parimet e arsimit fillor

Neni 4

Arsimi fillor zhvillohet në bazë të parimeve si vijojnë:

- interesi më i mirë dhe zhvillimi i plotë i nxënësit,
- barazia, arritshmëria, qasja dhe inkluziviteti,
- karakteri i përgjithshëm arsimor i arsimit fillor,
- siguri i cilësisë së arsimit dhe krahasimi ndërkombëtar i njohurive të nxënësve,
- pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën e shkollës dhe komunitetit,
- përgatitja e nxënësit për mësim gjatë gjithë jetës,
- avancimi i ngjashmërive dhe pranimi i diallimeve, interkulturës, multikulturalizmit, interkulturalizmit, interkulturalizmit,
- kujdesi për sigurinë dhe shëndetin fizik,
- autonomia, kompetenca dhe përgjegjësia dhe
- partneriteti ndërmjet shkollës, prindërve, përkatësisht kujdestarëve dhe njësive të vetëqeverisjes lokale.

Mbrojtja nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë

Neni 5

(1) Në edukimin dhe arsimin fillor ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, thirrja dhe nxitja e diskriminimit dhe ndihma në veprimin diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës nacional dhe etnike, të metave, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, shtetësisë, origjinës sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, llojeve tjera të bindjes, moshës, gjendjes familjare dhe martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore dhe statusit shoqëror, ose çfarëdo bazë tjetër e cila është paraparë me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në realizimin e të drejtave të arsimit fillor.

(2) Ndalohet çdo formë dhe lloj i diskriminimit në arsimin fillor, dhe atë në:

- procesin edukativ-arsimor,
- procesin e regjistrimit në arsimin fillor,
- arritshmërinë në shërbime dhe përfitimet, përshtatje dhe qasje racionale deri dhe në objekte,
- punësim, avancim në karrierë dhe ndërprerje të punësimit,
- organizimin e nxënësve,
- përmbajtjen e programeve mësimore dhe librave shkollore,
- menaxhim dhe pjesëmarrje në organet dhe trupat e shkollës,
- financimin ie arsimit fillor dhe
- çfarëdo sferë tjetër të arsimit fillor.

(3) Ndalimi për diskriminim ka të bëjë edhe me diskriminimin ndaj prindërve përkatësisht kujdestarëve të nxënësve në cilëndo bazë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Të punësuarit në shkolla fillore janë të detyruar të promovojnë barazi dhe drejtësi ndërmjet të gjithë nxënësve dhe aktivisht t'i kundërshtojnë të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës.

(5) Ndalimi për diskriminim ka të bëjë edhe me diskriminimin ndaj të punësuarve në shkolla fillore në cilëndo bazë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Mbrojtja nga diskriminimi sigurohet në pajtim me rregullat nga sfera e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Masa afirmative

Neni 6

(1) Në arsimin fillor zbatohen masa afirmative me qëllim tejkalimin e diskriminimit dhe përjashtimit të fëmijëve dhe të moshuarve.

(2) Masat afirmative nga paragrafi (1) i këtij neni janë: moszbatimi i dispozitës për rajonizim gjatë regjistrimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, lirimi nga pagesa e shpenzimeve për njohje dhe ekuivalencë të dëftesave të marra jashtë vendit, transporti falas për nxënësit me aftësi të kufizuara, medijatorët arsimorë, kompensim në para për vendin e parë të marrë në gara shtetërore, stimulimi për pjesëmarrje dhe kompensim në para për çmim/medalje të marrë në gara ndërkombëtare.

Qëllimet e arsimit fillor

Neni 7

Qëllimet e arsimit fillor janë:

- sigurimi i përfshirjes së plotë në procesin edukativ arsimor dhe përgjigja ndaj nevojave të llojllojshme të të gjithë nxënësve përmes sigurimit të pjesëmarrjes esenciale të të gjithë nxënësve në të,
- sigurimi i qasjes sistemore për nxitje të zhvillimit kognitiv, afektiv dhe psikomotorik të nxënësit në pajtim me karakteristikat potencialet dhe afinitetet e tij zhvillimore,
- arritja e standardeve nacionale për nxënësit në arsimin fillor nga sferat: edukimi gjuhësor, mësimi i gjuhëve tjera, matematika, shkencat natyrore dhe teknologjia, edukimi digjital, zhvillimi personal dhe social, kultura demokratike dhe qytetaria, sipërmarrësia dhe edukimi financiar si dhe shprehja artistike, kultura dhe multikulturalizmi,
- zhvillimi i vetëbesimit dhe vetëdijes te nxënësi për individualitetin dhe përgjegjësinë për veprimet e veta,
- edukimi për respektimin e dallimeve, bashkëpunimi, respektimi i dallimit, lirive dhe të drejtave themelore të njeriut,
- zhvillimi i shkrim leximit dhe aftësive të nxënësve për kuptim, informim dhe shprehje në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik,
- zhvillimi i shkrim leximit dhe aftësisë së nxënësve për kuptim, informim dhe shprehje, përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik edhe në gjuhën dhe alfabetin e pjesëtarëve të bashkësive që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase,
- zhvillimi i vetëdijes te nxënësit për përkatësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kultivimin e identitetit nacional, qytetar, etnik dhe kulturor,
- përgatitja e nxënësit për jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, qytetare dhe demokratike,
- zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive për hulumtim, eksperimentim dhe zgjidhje të problemeve,
- marrja e njohurive dhe shkathtësive të përgjithshme që janë të nevojshme që janë të nevojshme në jetën e përditshme ose për arsimin e mëtejshëm,
- aftësimi për arsim të mëtejshëm dhe mësim gjatë gjithë jetës;
- mbështetja e nxënësve të talentuar dhe me dhunti në sfera të ndryshme dhe
- avancimi i mënyrës së shëndoshë të jetesës dhe edukimit për marrje përsipër të përgjegjësisë për shëndetin personal dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Obligimi dhe periudhat e arsimit fillor

Neni 8

(1) Arsimi fillor është i obligueshëm, zgjat nëntë vite dhe organizohet në tri periudha edukativo-arsimore dhe atë nga klasa e parë deri në klasën e tretë, nga klasa e katërtë deri në klasën e gjashtë dhe nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

(2) Prindi, përkatësisht kujdestari i nxënësit është i detyruar që t'ia mundësojë fëmijës së tij ta përmbushë obligimin për arsim dhe edukim të detyrueshëm fillor.

Ndalimi i organizimit dhe veprimit partiak dhe fetar në shkollë fillore

Neni 9

Në shkollë fillore ndalohet organizimi dhe veprimi partiak dhe fetar, si dhe vendosja e shenjave partiake dhe fetare.

Përdorimi i gjuhëve në arsim

Neni 10

(1) Puna edukativo-arsimore në shkollë fillore realizohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(2) Për nxënësit e pjesëtarëve të bashkësive që ndjekin mësim në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe në alfabeti i saj cirilik, puna edukativo-arsimore realizohet në gjuhën dhe alfabetin e bashkësisë përkatëse.

(3) Nxënësit nga paragrafi (2) i këtij neni, e mësojnë detyrimisht gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

Arsimi inkluziv

Neni 11

(1) Arsimi fillor është organizuar në mënyrë institucionale, kadrovike dhe përmbajtësore në mënyrë që mbështet inkluzionin e të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt fillor.

(2) Arsimi inkluziv është proces i cili do t'i marrë parasysh nevojat e ndryshme individuale për zhvillim të nxënësve, duke dhënë mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave themelore për zhvillim dhe arsim cilësor.

(3) Arsimi inkluziv nga paragrafi (2) i këtij neni, përfshin ndryshime dhe përshtatje të përmbajtjes mësimore, qasjes, strukturave dhe strategjive për nxënësit me aftësi të kufizuara, me vizion dhe bindje të përbashkët se shteti ka obligim të sigurojë arsim për të gjitha fëmijët.

(4) Inkluzioni i të gjitha fëmijëve në arsimin e rregullt fillor definohet me Konceptin për arsim inkluziv, të cilin e miraton ministri me propozim të Byrosë dhe i njëjti publikohet në faqet e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme: Ministria) dhe Byrosë.

(5) Infrastruktura, mbështetja e individualizuar, plan-programi mësimor në arsimin fillor, janë përshtatur racionalisht sipas nevojave individuale të nxënësit.

(6) Përshtatja racionale nga paragrafi (5) i këtij neni, paraqet ndryshim dhe përshtatje të kushteve për edukim dhe arsim në rast të caktuar, që nuk shkakton ngarkim të shpërpjesëtimor ose të panevojshëm të shkollës, ndërsa është me qëllim për sigurimin e gëzimit ose realizimit të të gjitha të drejtave dhe lirive të nxënësve me aftësi të kufizuara në bazë të njëjtë me të tjerët.

(7) Qasja në infrastrukturë dhe shërbime nënkupton marrje të masave të cilat sigurojnë se nxënësit me aftësi të kufizuara kanë qasje, në bazë të barabartë me të tjerët, në mjedisin fizik, transport, informata dhe komunikim, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet informatike dhe të komunikimit në shkollë fillore.

Arsimi i fëmijëve të shtetasve që qëndrojnë jashtë vendit

Neni 12

(1) Për fëmijët e shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut që qëndrojnë jashtë vendit organizohet mësimi për mësim të gjuhës dhe kulturës maqedonase, ndërsa për pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në gjuhën amtare, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Punën edukativo-arsimore për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët janë me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë vendit, e realizojnë mësimdhënësit të cilët përveç kushteve të përcaktuara me këtë ligj, kanë së paku pesë vjet përvojë pune në mësim, dallohen në punën edukativo-arsimore dhe e njohin gjuhën e shtetit në të cilin do ta realizojnë mësimin.

(3) Fëmijëve të shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët kanë qëndruar jashtë vendit dhe janë kthyer në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku e fillojnë, përkatësisht e vazhdojnë arsimin fillor, shkollat fillore janë të detyruara që t'u ndihmojnë në mësimin e gjuhës amtare dhe gjuhës në të cilën do ta ndjekin mësimin.

(4) Për shkak të përfshirjes së suksesshme në procesin edukativo-arsimor të nxënësve nga paragrafi (3) i këtij neni, shkolla fillore në të cilën është regjistruar nxënësi organizon mësim plotësues individual dhe grupor për përvetësimin e gjuhës amtare dhe gjuhës në të cilën do ta ndjekin mësimin dhe për kompensimin e njohurisë nga lëndët e caktuara mësimore.

(5) Mësimi për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, realizohet sipas plan-programit mësimor të cilin e përgatit Byroja, ndërsa e përcakton ministri.

(6) Mësimi për nxënësit nga paragrafi (3) i këtij neni, zgjat më së shumti një vit dhe realizohet sipas programit të cilin e përgatit shkolla, ndërsa e miraton Byroja.

(7) Rroga dhe shpenzimet tjera për të cilat mësimdhënësi nga paragrafi (2) i këtij neni, ka të drejtë gjatë punës jashtë vendit, përcaktohet varësisht nga vëllimi i punës dhe detyrave të punës dhe kushtet e vështirësuara për punë.

(8) Mënyrën e zgjedhjes së mësimdhënësve të cilët i realizojnë planin dhe programin mësimor nga paragrafi (5) i këtij neni, si dhe mënyrën e përcaktimit të rrogave dhe shpenzimeve të mësimdhënësve nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton ministri.

Arsimi i fëmijëve me shtetësi të huaj ose fëmijëve pa shtetësi

Neni 13

(1) Fëmijët me shtetësi të huaj ose fëmijët pa shtetësi, fëmijët refugjatë, azilkërkuarit, fëmijët me status të refugjatit të pranuar, fëmijët nën mbrojtje subsidiare dhe fëmijët nën mbrojtje të përkohshme të cilët qëndrojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë të drejtë të arsimit fillor në kushte të barabarta si fëmijët shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Për fëmijët nga paragrafi (1) i këtij neni, organizohet mësimi i gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik dhe mbështetja për kompensim të njohurisë nga lëndë të caktuara mësimore në kohëzgjatje prej së paku një

viti në bazë të programeve të përgatitura nga Byroja, e të miratuara nga ministri.

(3) Fëmijë shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian kanë të drejtë të arsimit fillor në kushte të barabarta si dhe fëmijët shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Fëmijët shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian prindërit, përkatësisht kujdestarët e të cilëve, janë me qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku kryejnë ose kanë kryer veprimtari të pavarur, përkatësisht që janë të punësuar ose kanë qenë të punësuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë të drejtë të përvetësimit të njohurive në gjuhën dhe kulturën amtare të shtetit nga i cili vijnë.

(5) Ministria, në bashkëpunim me themeluesin e shkollës dhe shtetin nga i cili vjen nxënësi nga paragrafi (3) i këtij neni, e në pajtim me mundësitë, jep mbështetje për përvetësim të njohurisë nga gjuha dhe kultura amtare e shtetit nga i cili vjen nxënësi.

Arsimi i fëmijëve që nuk janë përfshirë në mësim

Neni 14

(1) Fëmijët që nuk janë përfshirë në mësim, e janë me kufi të tejkaluar të moshës për përfshirje në klasë përkatëse të arsimit fillor, kanë të drejtë të arsimit fillor në kushte të barabarta, si dhe fëmijët tjerë.

(2) Për fëmijët nga paragrafi (1) i këtij neni, përgatiten programe të përshtatura mësimore me të cilat do të mundësohet përfshirje në klasën përkatëse të arsimit fillor.

(3) Kontrollin e njohurive të fëmijëve nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryen shkolla para përfshirjes së tyre në procesin edukativo-arsimor, me instrumente të përcaktuara nga Byroja. Pas kontrollit të kryer të njohurisë së tyre, lëshohet vërtetim me të cilin fëmija regjistrohet në klasën përkatëse të arsimit fillor.

(4) Programet e përshtatura mësimore nga paragrafi (2) i këtij neni, i përgatit Byroja, ndërsa i përcakton ministri.

(5) Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (3) i këtij neni, e përcakton ministri me propozim të Byrosë.

Vendi i organizimit dhe realizimit të arsimit fillor

Neni 15

(1) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet në shkollë fillore.

(2) Arsimi fillor organizohet dhe realizohet edhe në institucione shëndetësore, institucione ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, si dhe në kushte shtëpiake, në pajtim me këtë ligj.

(3) Shkolla organizon proces edukativo-arsimor në kushte shtëpiake si formë e veçantë e punës për nxënës në mjekim më të gjatë shtëpiak.

(4) Për nxënësit të cilët, për shkak të problemeve shëndetësore ose sëmundjeve kronike, nuk mund të ndjekin mësim më gjatë se tri javë, mësimi organizohet në kushte shtëpiake, përkatësisht në institucion shëndetësor.

(5) Prindi, përkatësisht kujdestari e njofton shkollën për nevojën e mësimi të nxënësit i cili është në mjekim më të gjatë shtëpiak ose spitalor.

(6) Arsimin fillor në institucione shëndetësore dhe ndëshkimore-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, e realizon shkolla e cila është më afër institucionit dhe realizon mësim në gjuhën amtare të nxënësit në këto institucione, ndërsa në kushte shtëpiake shkolla ku është regjistruar nxënësi.

(7) Mënyrën e zgjedhjes së shkollës fillore, kriteret më të afërta dhe mënyrën e organizimit të mësimit në institucionet nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe në kushte shtëpiake i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Ekipet inkluzive

Neni 16

(1) Në shkollën fillore drejtori formon ekip inkluziv shkollor, i cili kujdeset për politika dhe praktika inkluzive në nivel të gjithë shkollës dhe ekip inkluziv për nxënësin i cili punon sipas planit arsimor individual (në tekstin e mëtejme: PAI) ose sipas programit mësimor të modifikuar nga neni 30 i këtij ligji.

(2) Ekipi inkluziv shkollor është me mandat prej tre vitesh shkollore dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, si vijon: pedagogu, përkatësisht psikologu, përkatësisht punëtori social i shkollës, dy mësimdhënës nga radhët e të punësuarve në shkollë (një mësimdhënës i mësimit klasor dhe një mësimdhënës i mësimit lëndor), dy prindër përkatësisht kujdestarë, edukatori dhe rehabilitatori special dhe drejtori i shkollës. Ekipi inkluziv shkollor i planifikon dhe realizon aktivitetet në nivel të gjithë shkollës dhe kujdeset që ato të harmonizohen dhe zbatohen në punën edukativo-arsimore.

(3) Ekipi inkluziv për nxënës është për periudhën deri në përfundimin e arsimit fillor të nxënësit dhe përbëhet nga: mësimdhënësit e nxënësit, prindi përkatësisht kujdestari, pedagogu përkatësisht psikologu, përkatësisht punëtori social i shkollës, edukatori dhe rehabilituesi special. Ekipi inkluziv për nxënës në fokus të punës së vet i ka nxënësit konkretë dhe përgatitjen dhe realizimin e planeve të tyre individuale arsimore.

(4) Në punën e ekipit inkluziv për nxënës, sipas nevojës mund të thirren dhe të marrin pjesë edhe nxënësi, mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesionalë tjerë ose cilido person tjetër i besueshëm i nxënësit.

(5) Nëse shkolla nuk ka të punësuar bashkëpunëtor profesional të profilit të caktuar, për anëtarë të ekipit inkluziv nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, caktohen persona nga qendrat për mbështetje të mësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe/ose shkollat me qendra e resurseve.

(6) Ekipi inkluziv për nxënës përgatit PAI dhe program mësimor të modifikuar për nxënësin me aftësi të kufizuara në pajtim me potencialet dhe nevojat e tij individuale, në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të mësimit të nxënësit në shkollë dhe i realizon masat për mbështetje në mësim në pajtim me rekomandimet nga trupat punues për vlerësim të mbështetjes plotësuese arsimore, shëndetësore dhe sociale të fëmijëve dhe të rinjve (në tekstin e mëtejme: trupa punues për vlerësim) në kuadër të Trupit Koordinues Nacional për implementimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Qeveria). Gjatë përpunimit të PAI dhe programit mësimor të modifikuar, ekipi inkluziv për nxënës bashkëpunon me mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesionalë tjerë të përfshirë në procesin arsimor të nxënësit.

Shkolla fillore me qendër të resurseve

Neni 17

(1) Shkolla me qendër të resurseve i përdor resurset e saj materiale dhe njerëzore dhe u jep mbështetje profesionale adekuate nxënësve me aftësi të kufizuara, kuadrit mësimor, bashkëpunëtorëve profesionalë, prindërve përkatësisht kujdestarëve dhe ekipit inkluziv të shkollave tjera fillore.

(2) Kuadri mësimor nga shkolla fillore me qendër të resurseve nga paragrafi (1) i këtij neni, merr pjesë edhe në realizimin e një pjesë të programit të modifikuar për nxënësit me nevoja komplekse për të cilat është në interes më të mirë të ndjekin një pjesë të mësimin në shkollë fillore me qendër të resurseve, e në pajtim me rekomandimin e trupit profesional për vlerësim, të bazuar në Klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit (tekstin e mëtejme: KNF), i miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Qendra për mbështetje të mësimin të nxënësve me aftësi të kufizuara

Neni 18

(1) Drejtori, në shkollën fillore ku ka paralele të veçanta, formon qendër për mbështetje të mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejme: qendra për mbështetje).

(2) Qendra për mbështetje i përdor resurset materiale dhe njerëzore në shkollë dhe u jep mbështetje profesionale përkatëse nxënësve me aftësi të kufizuara, kuadrit mësimor, bashkëpunëtorëve profesionalë, prindërve, përkatësisht, kujdestarëve dhe ekipit inkluziv në shkolla tjera fillore në rajonin e komunës.

(3) Kuadri mësimor nga qendra për mbështetje merr pjesë edhe në realizimin e një pjese të programit të modifikuar për nxënësit me nevoja komplekse për të cilët është në interes më të mirë të ndjekin një pjesë të mësimin në qendrën për mbështetje, e në pajtim me rekomandimin e trupit profesional për vlerësim, të bazuar në KNF.

Llojet e mbështetjes për nxënësit me aftësi të kufizuara

Neni 19

(1) Për mbështetjen e mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara, shkolla fillore siguron: asistent arsimor, asistent personal, mbështetje profesionale përkatëse nga qendra për mbështetje të mësimin, ekip inkluziv dhe teknologji asistuese me rekomandim të trupit profesional për vlerësim dhe në pajtim me planin arsimor individual ose programin e modifikuar.

(2) Thirrja publike për seleksionim dhe zgjedhje të asistentit arsimor/personal, seleksionim dhe zgjedhje të asistentit arsimor/personal, si dhe trajnimit të asistentit arsimor/personal, i realizon shkolla me qendër të resurseve.

(3) Thirrja publike nga paragrafi (2) i këtij neni, pas pëlqimit të marrë paraprakisht nga Ministria publikohet në së paku dy gazeta ditore nga të cilat së paku në një prej gazetave që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Mënyrën e kërkesës së asistentit arsimor/personal, mënyrën e seleksionimit dhe zgjedhjes së asistentit arsimor/personal, si dhe programin për trajnim të asistentit arsimor/personal i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(5) Seleksionimin dhe zgjedhjen e asistentit arsimor/personal e kryen Komisioni pesëanëtarësh nga radhët e të punësuarve në shkollë me qendër e resurseve, të cilin e formon drejtori i shkollës.

(6) Normativin për asistentin arsimor dhe asistentin personal, përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të punës i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(7) Asistentët arsimorë dhe personalë punësohen në kohë të caktuar nga shkolla me qendër të resurseve. Mjetet për asistentë arsimorë dhe asistentë personalë sigurohen nga Buxheti i Ministrisë.

(8) Nëse në nivel të komunës nuk ka shkollë fillore me qendër të resurseve ose me qendër për mbështetje, mbështetja e mësimi të nxënësve me aftësi të kufizuara sigurohet nga shkolla më e afërt fillore me qendër të resurseve ose nga shkolla me qendër për mbështetjen nga komuna më e afërt.

II. THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E PUNËS SË SHKOLLËS FILLORE

Veprimtaria e shkollës fillore

Neni 20

(1) Shkolla fillore kryen veprimtari me interes të veçantë publik.

(2) Shkolla fillore ka cilësi të personit juridik dhe regjistrohet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Shkolla fillore ka vulë. Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa anash emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe emri (emërtimi) dhe selia e shkollës.

Gjuha dhe alfabeti i emrit të shkollës fillore

Neni 21

(1) Emri i shkollës fillore është shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik.

(2) Në shkollat fillore në të cilat mësimi realizohet edhe në gjuhë dhe alfabet tjetër të ndryshëm nga gjuha maqedonase, emri i shkollës është shkruar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi.

Lloje dhe themelimi i shkollave fillore

Neni 22

(1) Edukimi dhe arsimi fillor zhvillohet në shkollë fillore, si vijon:

- shkollë fillore,
- shkollë fillore për arsimin e të moshuarve,
- shkollë fillore të muzikës,
- shkollë fillore të baletit,
- shkollë fillore me qendër e resurseve dhe

- shkollë fillore ndërkombëtare.
- (2) Shkolla fillore mund të jetë komunale ose shtetërore.
- (3) Shkolla fillore komunale themelohet nga komuna.
- (4) Shkolla fillore shtetërore themelohet nga Qeveria.
- (5) Këshilli i Komunës miraton vendim për themelimin e shkollës fillore komunale, pas mendimit të marrë paraprakisht nga Qeveria me propozim të Ministrisë.
- (6) Për përcaktimin e pëmbushjes së kushteve për themelimin e shkollës themelore komunale ministri formon komision të përbërë nga pesë anëtarë si vijon: nga një anëtar nga Byroja, Inspektorati shtetëror i Arsimit, themeluesi dhe dy anëtarë nga Ministria.
- (7) Shkollat fillore nga paragrafi (1) alinetë 2, 5 dhe 6 të këtij neni, janë shkolla fillore shtetërore të cilat i themelon Qeveria dhe themelohen për realizimin e planprogrameve mësimore për arsimin fillor të nxënësve të caktuar për të cilët shteti ka interes të veçantë.
- (8) Komuna, përkatësisht Qeveria mund të themelojë shkollë të muzikës dhe/ose të baletit në të cilën realizohet planprograme mësimore, të cilat me propozim të Byrosë i përcakton ministri.
- (9) Arsimi fillor i muzikës përkatësisht i baletit është i paobligueshëm dhe në të nxënësit përfshihen pas pëlqimit paraprak nga prindi i tyre përkatësisht kujdestari, e në drejtim të zhvillimit të afiniteteve të tyre muzikore dhe të baletit. Shpenzimet për ndjekje të arsimit të muzikës dhe të baletit i paguan prindi, përkatësisht kujdestari.
- (10) Mënyrën e regjistrimit të nxënësve dhe realizimit të mësimin në shkollat e muzikës dhe/ose të baletit nga paragrafi (8) i këtij neni, i përcakton ministri me propozim të Byrosë.
- (11) Mënyra e bashkëpunimit ndërmjet shkollës fillore me qendër të resurseve dhe shkollat tjera fillore rregullohen në akt të veçantë të miratuar nga ministri, me propozim të Byrosë.
- (12) Komuna, përkatësisht Qeveria mund të themelojë edhe shkollë fillore ndërkombëtare në të cilën realizohet planprogrami mësimor në ndonjë prej gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj), të cilat me propozim të Byrosë i përcakton ministri.

Kushte për themelimin e shkollës fillore

Neni 23

- (1) Shkolla fillore mund të themelohet, nëse:
 - ka numër të mjaftueshëm të nxënësve për formimin së paku nga dy paralele nga klasa e parë deri në klasën e nëntë,
 - është siguruar kuadër mësimor adekuat,
 - janë siguruar hapësira shkollore, pajisje dhe mjeteve mësimore adekuate të përcaktuara në pajtim me normativat dhe standardet dhe
 - janë siguruar mjete të nevojshme financiare.
- (2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, shkolla fillore mund të themelohet edhe kur nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve për formimin e 18 paraleleve, nëse themeluesi siguron mjete të mjaftueshme financiare për punë.
- (3) Normativat dhe standardet nga paragrafi (1) alineja 3 e këtij neni, i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(4) Themeluesi është i detyruar që gjatë themelimit të shkollës fillore komunale të formojë komision të përbërë prej pesë anëtarësh nga radhët e të punësuarve në komunë, i cili në pajtim me ligjin kryen përgatitje për fillim me punë të shkollës.

Akti për themelimin e shkollës fillore

Neni 24

(1) Me aktin për themelimin e shkollës fillore përcaktohen:

- emri dhe selia e shkollës fillore,
- programi për veprimtari edukative arsimore,
- numri i nxënësve,
- rajoni, përkatësisht rajonet nga të cilët përfshihen nxënësit,
- gjuha/gjuhët në të cilën realizohet mësimi,
- numri i shkollave rajonale,
- kuadri i nevojshëm mësimor, pajisja, hapësira sipas standardeve dhe normativave,
- mjetet të cilat themeluesi i ka siguruar për themelim dhe fillim me punë të shkollës fillore dhe mënyra e sigurimit të mjeteve dhe
- fillimi me punë të shkollës fillore.

(2) Shkolla fillore mund të fillojë me punë pasi që Ministria do të konstatojë se janë përmbushur kushtet nga neni 23 paragrafi (1) i këtij ligji, dhe do të marrë aktvendim për verifikim, në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(3) Kontroll për përmbushjen e kushteve për themelimin e shkollës fillore dhe për verifikim kryen komisioni, i formuar nga ministri.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, përbëhet prej pesë anëtarësh si vijon: nga një anëtar nga Byroja, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, themeluesi dhe dy anëtarë nga Ministria.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(6) Mënyrën e përcaktimit të përmbushjes së kushteve për themelimin e shkollës fillore dhe verifikimin e shkollës fillore e përcakton ministri.

Shkolla rajonale

Neni 25

(1) Shkolla fillore në përbërje të saj mund të ketë shkollë rajonale.

(2) Shkolla rajonale organizohet në vendbanim me numër të vogël të nxënësve, për çfarë vendos themeluesi, pas mendimit pozitiv paraprak nga ministri.

Statuti i shkollës fillore

Neni 26

(1) Shkolla fillore ka statut.

(2) Me statut veçanërisht rregullohen: organizimi dhe kryerja e veprimtarisë edukativo-arsimore, emërtimi, selia, menaxhimi dhe udhëheqja,

të drejtat dhe obligimet e nxënësve, organizimi i nxënësve, të drejtat dhe obligimet e të punësuarve dhe çështje tjera me rëndësi për punën e shkollës fillore.

(3) Statutin e shkollës fillore e miraton Këshilli i Shkollës.

(4) Për statutin e shkollës fillore pëlqim jep Ministria, pas mendimit të marrë paraprakisht pozitiv nga themeluesi.

Regjistri

Neni 27

(1) Ministria mban regjistër qendror të shkollave fillore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Çdo komunë për rajonin e vet mban regjistër të shkollave fillore dhe për këtë dorëzon të dhëna në Ministri.

(3) Regjistrat nga paragrafët (1) dhe (2) i këtij neni, mbahen në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(4) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përcakton ministri.

Ndërprerja e punës së shkollës fillore

Neni 28

(1) Shkolla fillore e ndërpret punën nëse nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

(2) Procedurë për ndërprerje të punës të shkollës fillore ngrit dhe udhëheq themeluesi, e pas pëlqimit paraprak të Ministrisë.

(3) Procedurë për ndërprerje të punës të shkollës fillore rajonale ngrit dhe udhëheq themeluesi, pas pëlqimit paraprak të Ministrisë.

(4) Me përjashtim të paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, procedurë për ndërprerje të punës të shkollës fillore dhe shkollës fillore rajonale ngrit edhe Ministria, pas pëlqimit paraprak nga Qeveria, nëse nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

Procedura për ndërprerje të punës së shkollës fillore

Neni 29

(1) Themeluesi i shkollës fillore miraton akt për ndërprerje të punës nëse shkolla fillore:

- nuk i realizon qëllimet dhe detyrat e edukimit dhe arsimit dhe

- ka pushuar t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Pas miratimit të aktit për ndërprerje të punës së shkollës fillore, themeluesi është i detyruar që nxënësve t'u sigurojë që ta vazhdojnë arsimin, në llogari të themeluesit.

(3) Shkolla fillore pas miratimit të aktit për ndërprerje të punës shlyhet nga regjistrat nga neni 27 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(4) Akti për ndërprerje të punës së shkollës fillore shpallet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në fletën zyrtare të komunës.

(5) Themeluesi, në afat prej tri ditësh pas miratimit të aktit për ndërprerje të punës së shkollës fillore, e njofton Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shlyerje nga regjistri.

III. PROGRAME DHE ORGANIZIMI I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE NË SHKOLLË FILLORE

Plani mësimor dhe programet mësimore

Neni 30

(1) Ministri, me propozim të Byrosë, e përcakton Konceptin për arsimin dhe edukimin fillor, në bazë të të cilit miratohen plani mësimor dhe programet mësimore për arsimin fillor (në tekstin e mëtejme: plani dhe programet mësimore).

(2) Ministri, me propozim të Byrosë, i përcakton standardet nacionale për nxënësit në arsimin fillor, të bazuara në kompetenca të cilat nxënësit duhet t'i marrin në fund të arsimit fillor. Standardet nacionale për nxënësit në arsimin fillor, e përcaktojnë nivelin e parë të Kornizës nacionale të kualifikimeve.

(3) Në shkollën fillore puna edukativo-arsimore organizohet dhe realizohet sipas planit dhe programeve mësimore nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilat me propozim të Byrosë, i përcakton ministri.

(4) Plani mësimor për arsimin fillor përmban lëndë të detyrueshme dhe zgjedhore dhe orë për komunitetin klasor, të përcaktuara me numrin vjetor dhe javor të orëve për mësimin veçmas për lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore, shpërndarjen e tyre nëpër klasa.

(5) Me planin mësimor përcaktohen edhe mësim plotësues dhe shtesë, aktivitete jashtëmësimore dhe gjuha në të cilën realizohet mësimi.

(6) Me programet mësimore përcaktohen rezultatet nga mësimi, nocionet themelore, aktivitetet dhe metodat në mësim, standardet për vlerësim të arritjes së nxënësve, kushtet për realizimin e programit mësimor dhe normativa për kuadër mësimor.

(7) Mësimi për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkolla fillore realizohet sipas Planit arsimor individual të programeve mësimore nga paragrafi (6) i këtij ose programit të modifikuar mësimor.

(8) Plani arsimor individual përfshin adaptime në rezultatet nga mësimi i programit mësimor, futja e aktiviteteve dhe metodave specifike që mundësojnë arritje të rezultateve nga mësimi.

(9) Programi i modifikuar mësimor, i dedikuar për nxënësit me nevoja komplekse, përgatitet për çdo periudhë edukativo-arsimore të arsimit fillor dhe me të përcaktohen rezultatet nga mësimi bazuar në kompetenca me të cilat duhet t'i marrin dhe zhvillojnë pavarësi, zhvillim personal dhe marrëdhënie sociale.

(10) Për kategori të caktuara të nxënësve me aftësi të kufizuara zhvillohen programe për shkathtësi specifike, si: mobilitet dhe orientim në hapësirë, mësimi i alfabetit Braj, zhvillimi i të folurit, përdorimi i teknologjisë asistuese për komunikim etj.

Mësimi plotësues

Neni 31

(1) Mësimi plotësues organizohet për nxënësit të cilët kanë nevojë për mbështetje plotësuese për lëndë të caktuara mësimore që t'i arrijnë rezultatet e pritura, përkatësisht me kërkesë të nxënësit, prindit, përkatësisht kujdestarit të tij ose sipas vlerësimit të mësuesit.

(2) Mësimdhënësi e planifikon mësimin plotësues në pajtim me nevojat e nxënësve.

(3) Për nevojën e ndjekjes së mësimin plotësues, mësimdhënësi klasor, përkatësisht lëndor, mban evidencë dhe e njofton prindin, përkatësisht kujdestarin e fëmijës në afat prej tri ditësh nga konstatimi i nevojës.

Mësimi shtesë

Neni 32

(1) Mësimi shtesë organizohet për nxënësit të cilët arrijnë rezultate të konsiderueshme për lëndë të caktuara mësimore.

(2) Mësimin shtesë për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, mësimdhënësi është i detyruar t'ua ofrojë nxënësve, ndërsa nxënësit vendosin nëse do ta ndjekin mësimin shtesë.

Realizimi i mësimin shtesë dhe plotësues

Neni 33

(1) Shkolla fillore në bazë mujore përgatit orar për mësim plotësues dhe shtesë për çdo lëndë mësimore dhe e publikon në tabelën e shpalljes dhe në faqen e vet të internetit.

(2) Organizimin dhe mënyrën e realizimit të mësimin plotësues dhe shtesë i rregullon ministri, me propozim të Byrosë.

Nxënësit e talentuar dhe me dhunti

Neni 34

(1) Ministri me propozim të Byrosë miraton Koncept për zbulimin dhe punën me nxënësit e talentuar dhe me dhunti.

(2) Në përpilimin e konceptit për zbulimin dhe punën me nxënës të talentuar dhe me dhunti, detyrimisht marrin pjesë nga një përfaqësues nga secila shoqatë e akredituar për realizimin e garave në shkollë fillore.

(3) Nxënësit e talentuar dhe me dhunti janë nxënës që kanë zhvilluar një ose më shumë aftësi në nivel i cili i tejkalon aftësitë e bashkëmoshatarëve të tyre. Dhuntia sipas rregullit ka të bëjë me arritje të larta në sferën e shkencave natyrore, matematikës, gjuhëve, ndërsa talenti sipas rregullit ka të bëjë me arritjet në sferën e artit, të shprehurit figurativ, muzikës, dizajnit dhe sportit.

(4) Me Konceptin nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullohen njohja dhe identifikimi i nxënësve të talentuar dhe me dhunti, masat dhe aktivitetet për punë.

(5) Çdo mësues, përveç orëve të cilat i mban në kuadër të fondit të tij javor të orëve, kalon edhe pesë orë pune në javë në punë të drejtpërdrejtë me nxënësit që të realizohen mësimi plotësues dhe shtesë, puna me nxënësit e talentuar dhe me dhunti, puna e seksioneve dhe aktivitetet jashtëmësimore.

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Neni 35

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, në kuptim të këtij ligji janë:

- nxënës me aftësi të kufizuara janë ata që kanë dëmtime afatgjate fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, të cilët në bashkëveprim me barrierat e ndryshme shoqërore mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqërinë në bazë të barabartë me të tjerët,
- nxënës me çrregullime në sjellje ose probleme emocionale, ose me vështirësitë specifike në mësim dhe
- nxënësit të cilët vijnë nga mjediset e pavolitshme socio-ekonomike, kulturore, dhe/ose mjediset e deprivuara gjuhësore.

Kujdestaria e nxënësve

Neni 36

(1) Ministria siguron mbështetje plotësuese për nxënësit, për lëndët që janë pjesë e planit mësimor në vitin mësimor në të cilin është regjistruar nxënësi, pas pëlqimit të marrë paraprakisht me shkrim nga prindi, përkatësisht kujdestari.

(2) Mbështetjen plotësuese nga paragrafi (1) i këtij neni, e realizon kujdestari-vullnetar, në pajtim me Programin për sigurim të kujdestarisë së nxënësve nga arsimi fillor, që e përcakton ministri.

(3) Kujdestari-vullnetar, mund të jetë student i rregullt i cili mëson vullnetarisht nxënës dhe i cili i përmbush kriteret e veçanta për zgjedhje si kujdestar/vullnetar të përcaktuara në programin nga paragrafi (2) i këtij neni.

Mediatorët arsimorë

Neni 37

(1) Për nxënësit romë që vijnë nga familjet e rrezikuara sociale dhe/ose janë një kohë më të gjatë jashtë sistemit arsimor, mund të angazhohen mediatorë arsimorë.

(2) Mediatori arsimor nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërmerr aktivitete për përmirësim të informimit për mundësitë dhe qasjen në shkolla, realizon takime të rregullta për sensibilizim të popullatës dhe të punësuarve në shkollë fillore me specifikat dhe nevojat e grupeve të cenushme në pjesën e arsimit, bashkëpunimin e rregullt me bashkëpunëtorët profesionalë dhe mësimdhënësit për përmirësimin e arritjeve të nxënësve, ndërmerr aktivitete për zvogëlim të braktisjes së procesit edukativo-arsimor të nxënësve.

(3) Nevoja për angazhimin e mediatorit arsimor bëhet me kërkesë të shkollës në të cilën është regjistruar ose duhet të regjistrohet nxënësi nga paragrafi (1) i këtij neni, e cila dorëzohet në Ministri më së voni deri më 15 shtator në vitin rrjedhës.

(4) Mediatorët arsimorë angazhohen përmes thirrjes publike, të cilën e publikon Ministria në faqen e internetit, më së voni deri më 1 tetor në vitin rrjedhës.

(5) Për zgjedhjen e mediatorëve arsimorë ministri formon komision të përbërë prej pesë anëtarëve, nga të cilët tre anëtarë janë nga radhët e të

punësuarve në Ministri, një përfaqësues nga Byroja dhe një përfaqësues nga organizatat civile që punojnë në avancimin e të drejtave të romëve.

Ora e komunitetit klasor

Neni 38

Në orën e komunitetit klasor përpunohen përmbajtje për zhvillimin personal dhe socioemocional të nxënësve sipas programit që e përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe aktivitete tjera lidhur me paralelen.

Programi eksperimental dhe projekti zhvillimor hulumtues

Neni 39

(1) Në shkollë fillore mund të realizohen programi eksperimental dhe projekti zhvillimor-hulumtues, për shkak të avancimit të procesit edukativo-arsimor.

(2) Programin eksperimental dhe projektin zhvillimor-hulumtues nga paragrafi (1) i këtij neni, i përgatit dhe/ose propozon Byroja, ndërsa i përcakton ministri.

(3) Në shkolla fillore mund të realizohen edhe projekte për avancimin e procesit edukativ arsimor ose për qëllime hulumtuese.

(4) Kërkesa për realizimin e projekteve nga paragrafi (3) i këtij neni, parashtrohet në Ministri.

(5) Lejen për realizimin e projekteve nga paragrafi (3) i këtij neni, e jep ministria, pas mendimit pozitiv paraprak nga Byroja.

Programi i zgjeruar

Neni 40

(1) Në shkollë fillore realizohet edhe programi i zgjeruar.

(2) Programi i zgjeruar i shkollës fillore përfshin: pranim dhe mbrojtje të organizuar të nxënësve një orë para fillimit të orëve në mësimin e rregullt dhe një orë pas përfundimit të mësimin të rregullt, qëndrim të vazhduar, mësim plotësues dhe shtesë, si dhe aktivitete jashtëmësimore dhe jashtëshkollore, përkatësisht organizim të seksioneve, klubeve, ekskursioneve, garave, aktiviteteve tjera të cilat shkolla i realizon jashtë programit mësimor, si dhe aktivitete të organizatës së nxënësve.

(3) Shkolla fillore për nxënës në klasën e parë, dytë dhe të tretë organizon pranim dhe mbrojtje të nxënësve një orë para fillimit të orëve për mësimin e rregullt dhe një orë pas përfundimit të mësimin, në pajtim me prindin përkatësisht kujdestarin.

(4) Shkolla fillore për nxënësit nga klasa e parë deri te e treta mund të organizojë qëndrim të vazhduar me nxënësit nga paralelja e njëjtë, nga klasa e njëjtë ose nga klasat e ndryshme, pas pëlqimit të marrë nga Ministria. Në qëndrimin e vazhduar nxënësit përfshihen me pëlqimin e prindit përkatësisht kujdestarit.

(5) Nëse sigurohen kushte dhe mjete nga themeluesi, shkolla fillore mund të organizojë qëndrim të vazhduar për nxënësit në grupe dhe atë, nga klasa e parë deri në klasën e pestë me nxënësit nga klasa e njëjtë, ose nga klasa e parë deri në klasën e tretë dhe nga e klasa e katërtë dhe e pestë me

nxënësit nga klasat e ndryshme. Në qëndrimin e vazhduar nxënësit përfshihen me pëlqimin e prindit përkatësisht kujdestarit.

(6) Nëse në qëndrimin e vazhduar janë përfshirë të gjithë nxënësit nga paralelja e njëjtë gjatë gjithë qëndrimit organizohet mësimi në pajtim me Udhëzimin për mësim në qëndrimin e vazhduar të nxënësve nga paralelja e njëjtë, që e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(7) Gjatë qëndrimit të vazhduar në të cilin janë përfshirë nxënësit nga paralelet dhe klasat e ndryshme, nxënësit mësojnë, i punojnë detyrat e shtëpisë, punojnë obligime tjera shkollore dhe marrin pjesë në aktivitete kulturore artistike, sportive dhe aktivitete tjera, në pajtim me programin vjetor për punën e shkollës, në pajtim me Udhëzimin për mësim në qëndrimin e vazhduar të nxënësve nga paralelet dhe klasat e ndryshme, që e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Aktivitetet jashtëmësimore

Neni 41

(1) Për zhvillimin e interesave të ndryshme të nxënësve, shkolla fillore organizon aktivitete jashtëmësimore në pajtim me Konceptin për aktivitete jashtëmësimore të cilin me propozim të Byrosë, e përcakton ministri.

(2) Aktivitetet jashtëmësimore të cilat i realizon shkolla fillore përcaktohen me programin vjetor për punën e shkollës.

(3) Nxënësit në aktivitete jashtëmësimore përfshihen vullnetarisht.

(4) Për pjesëmarrje në aktivitete jashtëmësimore mbahet evidencë në ditarin e paraleles dhe në fund të vitit shkollor nxënësit i lëshohet shtojcë në dëftesë, në të cilën shënohet pjesëmarrja në aktivitete jashtëmësimore.

(5) Shkolla gjatë organizimit të aktiviteteve jashtëmësimore mban llogari për mbrojtje nga diskriminimi sipas cilësdo bazë, si dhe për zbatimin e masave afirmative për përfshirje të të gjithë nxënësve.

(6) Për aktivitetet jashtëmësimore shkollat mund të marrin mjete nga buxhetet e komunave.

(7) Për aktivitetet jashtëmësimore shkollat, mund të marrin mjete për financim nga pjesëmarrja e projekteve, kontribute vullnetare, donacione, dhurata (në para, të mira, të drejta pronësore), testamente dhe legate.

Ekskursionet, piknikë dhe aktivitete jashtëshkollore

Neni 42

(1) Shkolla planifikon dhe organizon ekskursionet, piknikë dhe aktivitete tjera jashtëshkollore në pajtim me programin vjetor për punën e shkollës.

(2) Mënyrën e realizimit të ekskursioneve, piknikëve dhe aktiviteteve tjera jashtëshkollore i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Klubet sportive shkollore

Neni 43

(1) Për zhvillimin dhe avancimin e të gjitha formave të aktiviteteve sportive të nxënësve, së paku pesë mësimdhënës të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në shkollën fillore, themelojnë klub

sportiv shkollor, në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe Ligjin për sport.

(2) Me klubin sportiv shkollor menaxhojnë anëtarët drejtpërdrejt.

(3) Shkollat mjetet për financim të klubeve sportive shkollore i marrin nga kontributet vullnetare, donacionet, dhuratat (në para, të mira, të drejta pronësore), testamente dhe legate. Shkolla për klubin sportiv shkollor mund të marrë mjete nga buxhetet e komunave.

(4) Shkollat themeluesit i paraqet raport për mjetet e shfrytëzuara për financim të klubeve sportive shkollore, më së voni deri më 20 qershor në vitin rrjedhës, për vitin mësimor paraparak.

Garat e nxënësve

Neni 44

(1) Për nxënësit që tregojnë sukses të veçantë për lëndë të caktuara mësimore organizohen gara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror.

(2) Garat i organizojnë shoqatat e akredituara të mësimdhënësve.

(3) Shoqatat e mësimdhënësve duhet të jenë të akredituara nga Ministria, me propozim të komisionit për akreditimin e shoqatave të mësimdhënësve të formuar nga ministri, në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për akreditimin e garave të nxënësve.

(4) Komisioni është i përbërë nga shtatë anëtarë prej të cilëve tre janë përfaqësues të Ministrisë, dy nga Byroja, një nga Qendra Shtetërore e Provimeve dhe një përfaqësues nga sindikati reprezentativ i arsimit. Njëri anëtar i komisionit është kryetar, të cilin e emëron ministri.

(5) Krite themelore për akreditimin e shoqatave të mësimdhënësve për organizimin e garave janë që garat e nxënësve të organizohen nga ana e mësimdhënësve që mbajnë mësim për lëndë të caktuar mësimore, shoqatat e mësimdhënësve të jenë të regjistruara si shoqatë së paku tre vjet deri në ditën kur aplikojnë për organizimin e garave dhe të sigurojë organizimin e garave në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në të gjitha gjuhët mësimore.

(6) Për akreditimin e shoqatave të mësimdhënësve për organizimin e garave për nxënës, Ministria shpall thirrje publike në faqen e vet të internetit.

(7) Shoqata e mësimdhënësve për marrjen e akreditimit për organizimin e garave në Ministri parashtron kërkesë me dokumentacionin në shtojcë si vijon:

- dokument për veprimtarinë e regjistruar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- gjendja rrjedhëse e shoqatës së mësimdhënësve e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit të shoqatës së mësimdhënësve të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- statuti i shoqatës së mësimdhënësve,

- rregullorja për organizimin e garave të shoqatës së mësimdhënësve dhe

- kalendari trevjeçar për zbatimin e garave për nxënësit në shkollat fillore në të cilat do të përmbahen lëndët mësimore, periudha kohore për

realizimin e garave dhe mësimdhënësit përgjegjës që do të përfshihen në organizimin dhe realizimin e secilës garë.

(8) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni për lëshimin e akreditimit për organizimin e garave i përcakton ministri.

(9) Për vendin e parë të fituar në garë në nivel shtetëror nxënësit dhe mësimdhënësit të tij u ndahet shpërblimi me para, lartësinë e të cilit e përcakton ministri, me propozim të komisionit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(10) Nëse është fituar vendi i parë në garë në nivel shtetëror nga një grup nxënësish, nxënësve dhe mësimdhënësve të tyre u ndahet shpërblimi me para, lartësinë e të cilit e përcakton ministri, me propozim të komisionit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(11) Lartësia e shpërblimit me para nga paragrafi (9) i këtij neni, është në shumë më së shumti deri më 50% të neto rrogës mesatare të paguar për punëtor në Republikë në muajin e fundit para ndarjes së shpërblimit.

(12) Lartësia e shpërblimit me para nga paragrafi (10) i këtij neni, për grupin e nxënësve është në shumë më së shumti deri në një rrogë e gjysmë neto mesatare e paguar për punëtor në Republikë në muajin e fundit para ndarjes së shpërblimit dhe paguhet në mënyrën që shpërblimi u ndahet të gjithë nxënësve në grup në shumë të barabartë, ndërsa mësimdhënësit në shumë më së shumti deri në 50% të neto rrogës mesatare të paguar për punëtor në Republikë në muajin e fundit para ndarjes së shpërblimit.

(13) Kërkesat nga nxënësi, përkatësisht nga mësimdhënësi i tij për pagesën e shpërblimit me para për vendin e parë të fituar në garë në nivel shtetëror në vitin shkollor, dërgohen në Ministri, më së voni deri më 31 dhjetor në vitin rrjedhës kur është organizuar gara.

(14) Mënyrën dhe kriteret më të afërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve për lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Garat ndërkombëtare

Neni 45

(1) Ministria, për shpërblimin e parë, të dytë ose të tretë të fituar ose medaljen e artë, të argjendtë, përkatësisht të bronzitë në garë ndërkombëtare në fushën e matematikës, informatikës dhe shkencave natyrore, nxënësit, mësimdhënësit që e ligjëron lëndën në këto fusha, si dhe mentorit i cili e ka përgatitur nxënësin për garë, veçmas u ndan shpërblim me para në shumë prej 100% të neto rrogës mesatare të paguar për punëtor në Republikë në muajin e fundit para ndarjes së shpërblimit për shpërblimin e parë/medaljen e artë të fituar, 80% për shpërblimin e dytë/medaljen e argjendtë të fituar dhe 60% për shpërblimin e tretë/medaljen e bronzitë të fituar.

(2) Me garë ndërkombëtare nga paragrafi (1) i këtij neni, nënkuptohet gara në të cilën marrin pjesë nxënësit e së paku dhjetë shteteve të ndryshme, në të cilën krahasohen njohuritë ndërmjet nxënësive nga shtetet e ndryshme, bëhet rangimi i nxënësve më të mirë nga të gjitha vendet që marrin pjesë.

(3) Ministria për garat ndërkombëtare që realizohen në formë elektronike në largësi nuk ndan shpërblim me para nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Për ndarjen e shpërblimit me para nga paragrafi (1) i këtij neni, Ministria shpall thirrje publike një herë në vit, në faqen e vet të internetit.

(5) Ministria, me kërkesë të shoqatave të akredituara të mësimdhënësve për pjesëmarrje në një garë ndërkombëtare nga paragrafi (2), në fushat nga paragrafi (1) i këtij neni, mundet gjatë një viti t'i mbulojë shpenzimet për kuotizim dhe rrugë të më së shumti gjashtë nxënësve dhe më së shumti tre mentorëve, numri i të cilëve varet nga rregullat e organizatorëve të garës ndërkombëtare.

(6) Për mbulimin e shpenzimeve nga paragrafi (5) i këtij neni, Ministria shpall thirrje publike në faqen e vet të internetit në tre muajt e parë të vitit.

(7) Shoqata e mësimdhënësve pas thirrje publike nga paragrafi (6) i këtij neni, në Ministri parashtron kërkesë me dokumentacionin në shtojcë si vijon:

- njoftimi për zgjedhjen e bërë të nxënësve që do të marrin pjesë në garë ndërkombëtare dhe të dhënat për ta,

- njoftimi për mentorët e nxënësve që do të marrin pjesë në garë ndërkombëtare dhe të dhënat për ta,

- njoftimi nga organizatori i garës ndërkombëtare për lartësinë e kuotizimit për pjesëmarrje në garë dhe

- përlllogaritja për lartësinë e shpenzimeve të rrugës.

(8) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton ministri.

(9) Kërkesat e dërguara nga paragrafi (7) i këtij neni, i shqyrton komisioni i formuar nga ministri, i cili është i përbërë nga pesë anëtarë, prej të cilëve tre janë përfaqësues të Ministrisë dhe dy të Byrosë. Njëri anëtar i komisionit është kryetar, të cilin e emëron ministri.

(10) Komisioni nga paragrafi (9) i këtij neni, përpilon raport me propozim-listën e shoqatave të cilave do t'u mbuloohen shpenzimet nga paragrafi (5) i këtij neni, në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni.

(11) Ministri në bazë të raportit nga paragrafi (10) i këtij neni, miraton aktvendim për mbulimin e shpenzimeve nga paragrafi (5) i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së raportit.

Avancimi i multikulturalizmit/interkulturalizmit dhe integritit ndëretnik

Neni 46

(1) Drejtori i shkollës formon ekip për integrimin shkollor për periudhë prej tre vitesh, të përbërë prej pesë deri më shtatë anëtarë, kryetari i parlamentit të nxënësve, avokati i nxënësve dhe nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe mësimdhënësve. Drejtori ose ndihmësdrejtori është anëtar i ekipit për integrimin shkollor sipas funksionit. Gjatë formimit të ekipit për integrimin shkollor drejtori kujdeset për përfaqësimin e mësimdhënësve, nga të gjitha gjuhët në të cilat realizohet mësimi në shkollë.

(2) Ekipi për integrimin shkollor planifikon dhe organizon aktivitete që kontribuojnë në respektimin e multikulturalizmit dhe për zhvillimin e dialogut/interaksionit interkulturalor dhe avancimin e integritit ndëretnik.

(3) Ekipi për integrimin shkollor në bashkëpunim me mësimdhënësit detyrimisht përpilon plan për aktivitetet që do të planifikohen edhe në

programin vjetor të shkollës në drejtim të avancimit të interkulturalizmit, njohjes së ngjashmërive, pranimit të dallimeve, mposhtjes së stereotipeve dhe paragjyqimeve.

(4) Krite themelore sipas të cilave duhet të organizohet aktiviteti nga paragrafi (2) i këtij neni, konsiderohet aktiviteti që ka për qëllim interaksionin, përkatësisht integrimin e grupeve të përziera etnike/gjuhësore të pjesëmarrësve, grupeve të balancuara të pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe moshës, interaksionin ndërmjet pjesëmarrësve nga grupe të ndryshme etnike/gjuhësore (gjatë aktivitetit nxënësit e njëres gjuhës mësimore/njërit grup etnik bashkëpunojnë me nxënësit e gjuhës tjetër mësimore/grupit tjetër etnik, shfrytëzimin e të gjitha gjuhëve të përfaqësuara, trajtimin e barabartë të nxënësve nga të gjitha grupet etnike/gjuhësore, arritjen e qëllimeve të përbashkëta konkrete (produkteve të prekshme/të dukshme) me pjesëmarrjen e të gjitha bashkësive të përfaqësuara etnike.

(5) Mjetet për realizimin e këtyre aktiviteteve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, buxhetet e komunave dhe nga burimet tjera (donacione, legate, dhurata, etj.), ndërsa shfrytëzohen me dedikim.

(6) Për ndarjen e mjeteve për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi (4) i këtij neni, Ministria shpall thirrje publike në faqen e internetit të Ministrisë, një herë në vit në muajin tetor.

(7) Për ndarjen e mjeteve për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi (4) i këtij neni, ministri formon Komision të përbërë nga tre përfaqësues të Ministrisë dhe nga një përfaqësues të Byrosë dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Lartësia e mjeteve për shkollë arrin më së shumti deri më 30.000 denarë.

Orientimi profesional i nxënësve

Neni 47

(1) Shkolla u ndihmon prindërve, përkatësisht kujdestarëve dhe nxënësve gjatë zgjedhjes së shkollës së mesme, në pajtim me karakteristikat, aftësitë dhe afinitetet e nxënësve.

(2) Për ndjekjen së afiniteteve individuale të nxënësve dhe dhënies së ndihmës nxënësve dhe prindërve të tyre, përkatësisht kujdestarëve në zgjedhjen e shkollës së mesme, psikologu përkatësisht pedagogu në shkollë shfrytëzon mjete për përcaktimin e aftësive, interesave dhe mundësive të nxënësve dhe realizon program për orientimin profesional për nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë, të cilin me propozim të Byrosë, e përcakton ministri.

Mbrojtja shëndetësore dhe sociale e nxënësve

Neni 48

(1) Shkolla bashkëpunon me institucionet shëndetësore për realizim të mbrojtjes shëndetësore nxënësve, posaçërisht në kryerjen e kontrolleve mjekësore të fëmijëve që regjistrohen në klasën e parë, realizimin e kontrolleve të rregullta mjekësore sistematike dhe vaksinimeve në pajtim me ligjin.

(2) Shkolla detyrimisht e informon prindin përkatësisht kujdestarin e nxënësit për realizimin e kontrolleve të rregullta mjekësore sistematike dhe vaksinimeve.

(3) Shkolla në bashkëpunim me institucionet kompetente kujdeset për mbrojtjen sociale, posaçërisht të nxënësve nga grupet e cenueshme të shoqërisë.

(4) Shkolla kujdeset për shëndetin seksual dhe reprodktiv të nxënësve nëpërmjet sigurimit të informatave të bazuara në njohuritë shkencore, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe promovimin e respektimit të dallimeve.

Planifikimi i punës së shkollës fillore

Neni 49

(1) Shkolla fillore përpilon Program zhvillimor për punë (në tekstin e mëtejme: Programi zhvillimor).

(2) Me Programin zhvillimor planifikohen qëllimet dhe vizioni për zhvillimin e shkollës në periudhën prej katër vitesh, me aktivitetet e theksuara konkretisht të shkollës në pajtim me dokumentet strategjike dhe të konceptit dhe dokumentet dhe udhëzimet profesionale të përcaktuara nga institucionet kompetente.

(3) Në bazë të Programit zhvillimor shkolla e përpilon programin vjetor për punën e shkollës fillore (në tekstin e mëtejme: Programi vjetor për punën) për çdo vit shkollor.

(4) Me programin vjetor për punë planifikohet mësimi në pajtim me planin mësimor, programin e zgjeruar dhe punën tjetër edukativo-arsimore në shkollë.

(5) Në kuadër të programit vjetor për punë planifikohet edhe:

- promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe pakujdesia, parandalimi i diskriminimit,
- orientimi profesional i nxënësve,
- integrimi ndëretnik dhe iniciativat e përbashkëta të nxënësve,
- praktikat inkluzive,
- bashkëpunimi me prindërit përkatësisht kujdestarët,
- aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit jetësor,
- aktivitetet kulturore të shkollës dhe
- të gjitha aktivitetet në pajtim me prioritetet e shkollës.

(6) Formën dhe përmbajtjen e programit zhvillimor dhe vjetor për punë i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(7) Këshilli i shkollës e dërgon programin vjetor për punën te themeluesi më së voni deri më 15 gusht në vitin shkollor rrjedhës për vitin e ardhshëm shkollor.

(8) Programin vjetor për punë nga paragrafi (7) i këtij neni, themeluesi e miraton deri më 31 gusht.

(9) Nëse programin vjetor për punë nuk e miraton themeluesi në afatin e përcaktuar në paragrafin (8) të këtij neni, konsiderohet se i njëjti është miratuar.

(10) Programin e miratuar vjetor për punë, shkolla fillore e dërgon në Byronë dhe në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit deri më 15 shtator në vitin shkollor rrjedhës, në formë elektronike.

(11) Shkolla fillore ka për detyrë t'i njoftojë nxënësit dhe prindërit përkatësisht kujdestarët me programin vjetor për punë, të drejtat dhe obligimet e të gjitha subjekteve të përfshira në procesin edukativo-arsimor, si dhe organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë dhe ta publikojë në faqen e vet të internetit.

IV. ORGANIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLË FILLORE

Viti shkollor

Neni 50

(1) Viti shkollor në shkollë fillore, sipas rregullit, fillon më 1 shtator, ndërsa përfundon më 31 gusht vitin e ardhshëm.

(2) Mësimi në vitin shkollor realizohet në 180 ditë mësimore.

(3) Mësimi në shkollë fillore nuk realizohet gjatë festave shtetërore dhe festave tjera të përcaktuara me ligj.

(4) Së paku gjysma e kohëzgjatjes së pushimit dimëror të nxënësve janë ditë të paguara jopune për të punësuarit në shkollë, që përcaktohet në Kalendarin për organizimin dhe punën e shkollës fillore. Këto ditë nuk janë pjesë e pushimit vjetor dhe nuk llogariten në kohëzgjatjen e tij.

(5) Mësimi mund të realizohet edhe në kohëzgjatje të shkurtuar për nxënësit nga neni 13 paragrafi (1) dhe neni 14 paragrafi (1) të këtij ligji, por jo më pak se 100 ditë mësimore, pas pëlqimit të marrë nga Ministria, sipas programit të veçantë mësimor të përcaktuar nga ministri, me propozim të Byrosë.

(6) Puna edukativo-arsimore nuk guxon të ndërpritet gjatë vitit mësimor, përveç për gjendjet e jashtëzakonshme (fatkeqësi natyrore, epidemi etj.), për çfarë vendos ministri dhe e përcakton organizimin e mësimit deri në fund të vitit shkollor, por jo më pak se 100 ditë mësimore, në bazë të programeve të shkurtuara mësimore, të përpiluara nga Byroja, ndërsa të miratuara nga ministri.

(7) Në rast të ndërprerjes së punës edukativo-arsimore për shkak të grevës, drejtori i shkollës fillore, me pëlqimin paraprak nga kryetari i komunës, ndërsa për shkollat fillore shtetërore nga ministri, ka për detyrë ta sigurojë realizimin e punës edukativo-arsimore me zëvendësimin e të punësuarve që bëjnë grevë, për kohën derisa zgjat greva.

Ora mësimore

Neni 51

(1) Ora mësimore zgjat 40 minuta.

(2) Ora mësimore për nxënësit me aftësi të kufizuara mund të zgjasë më shkurt se ora mësimore e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, nëse kjo është përcaktuar me planin arsimor individual të nxënësit.

(3) Ora mësimore për nxënësit në shkolla fillore të muzikës dhe baletit, mund të zgjasë më shkurt se ora mësimore e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, nëse kjo është përcaktuar me programet mësimore.

Organizimi i mësimit

Neni 52

- (1) Mësimi në vitin shkollor organizohet në dy gjysmëvjetorë.
- (2) Viti shkollor përcaktohet me Kalendarin për organizimin dhe punën e shkollës fillore.
- (3) Kalendarin nga paragrafi (2) i këtij neni, e miraton ministri.

Klasa dhe paralele

Neni 53

- (1) Mësimi në shkollë fillore realizohet në klasa dhe paralele.
- (2) Klasa është tërësi edukativo-arsimore në të cilën realizohen programet mësimore sipas planit mësimor për një vit shkollor. Nxënësit e klasës së njëjtë janë të ndarë në paralele.
- (3) Paralelja formohet nga nxënësit e klasës së njëjtë.
- (4) Numri i nxënësve në paralele është prej 20 deri në 30 nxënës.
- (5) Paralelja mund të formohet edhe me më pak se 20 nxënës pas pëlqimit të marrë nga themeluesi.
- (6) Themeluesi mund të formojë paralele nga paragrafi (5) i këtij neni, pas mendimit pozitiv paraprak nga Ministria.
- (7) Mësimin për lëndët zgjedhore shkolla e organizon në grupe për të cilat janë paraqitur së paku 15 nxënës nga klasa e njëjtë, nga paralelet e njëjta ose të ndryshme.
- (8) Në shkollën fillore duhet të formohet edhe paralelja e kombinuar, sipas rregullit, nga nxënësit e klasës së parë deri në klasën e tretë, me nxënësit e klasës së katërt dhe të pestë ose me nxënësit e klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë, pas pëlqimit të marrë nga themeluesi.
- (9) Themeluesi mund të formojë paralele të kombinuara nga paragrafi (8) i këtij neni, pas mendimit pozitiv paraprak nga Ministria.
- (10) Paralelja e kombinuar mund të ketë më së shumti deri në 10 nxënës.
- (11) Kur nuk mund të organizohet mësimi nëpër klasa në paralele për nxënësit në institucione shëndetësore, institucione ndëshkuese përmirësuese ose institucione edukative përmirësuese, shkolla më e afërt fillore organizon punë edukativo-arsimore individuale ose grupe.
- (12) Numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara në paralele e përcakton ekipi inkluziv shkollor nga neni 16 paragrafi (1) i këtij ligji, duke u kujdesur për ndarjen e barabartë nëpër paralele, në varësi nga lloji i aftësisë së kufizuar dhe lloji dhe vëllimi i përshtatjeve të nevojshme.

Realizimi i mësimit

Neni 54

- (1) Puna edukativo-arsimore në shkollë fillore i përfshin mësimin dhe format tjera të punës së organizuar me nxënësit.
- (2) Mësimin në klasën e parë e realizon mësimdhënësi i mësimit klasor, pedagogu ose mësimdhënësi i edukimit parashkollor.
- (3) Mësimin në klasën e dytë dhe të tretë e realizon mësimdhënësi i mësimit klasor ose pedagogu.
- (4) Për realizimin e mësimit në gjuhën angleze nga klasa e parë deri në klasën e tretë përfshihet mësimdhënësi i gjuhës angleze.

(5) Për realizimin e mësimit të arsimit fizik dhe shëndetësor nga klasa e parë deri në klasën e pestë përfshihet edhe mësimitdhënësi i arsimit fizik dhe shëndetësor.

(6) Mësimin në klasën e katërt e realizon mësimitdhënësi i mësimit klasor ose pedagogu, përveç për mësimin e gjuhës angleze dhe për mësimin e gjuhës maqedonase për nxënësit e pjesëtarëve të komuniteteve që mësimin e realizojnë në gjuhën dhe alfabetin që janë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(7) Mësimin në klasën e pestë vazhdon ta realizojë mësimitdhënësi i mësimit klasor ose pedagogu, përveç për mësimin e gjuhës angleze dhe për mësimin e gjuhës maqedonase për nxënësit e pjesëtarëve të komuniteteve që mësimin e realizojnë në gjuhën dhe alfabetin që janë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, ndërsa për shkencat natyrore dhe arsimin teknik përfshihen edhe mësimitdhënësit e lëndëve.

(8) Mësimin nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë e realizojnë mësimitdhënësit e lëndëve.

(9) Në qëndrimin e vazhduar për nxënësit nga klasa e parë punën edukativo-arsimore e realizojnë mësimitdhënësit për mësimit klasor, pedagogu ose mësimitdhënësit për edukim parashkollor, ndërsa nga klasa e dytë deri në klasën e pestë mësimitdhënësit për mësimit klasor ose pedagogu.

(10) Punën edukativo-arsimore në shkollat me qendra resurse dhe në qendrat për mbështetjen e të mësuarit e realizojnë mësimitdhënësit, edukatorët specialë dhe rehabilitatorët, edukuesit, pedagogët dhe psikologët me arsimin e lartë përkatës.

(11) Punën edukativo-arsimore në shkollat për arsimin fillor të muzikës dhe baletit e realizojnë mësimitdhënësit, korepetitorët, pedagogët dhe psikologët me arsimin përkatës.

Biblioteka e shkollës

Neni 55

(1) Biblioteka e shkollës është vendi për aktivitetet bibliotekare/informative, edukativo-arsimore dhe kulturore në shkollë me qëllim të zhvillimit të nxënësit shprehinë për lexim dhe shfrytëzim të shërbimeve të bibliotekës.

(2) Në bibliotekën e shkollës grumbullohet, përpunohet materiali i bibliotekës (librat, publikimet serike, e ngjashëm) dhe u jepen në shfrytëzim nxënësve dhe kuadrit të të punësuarve.

(3) Në bibliotekë organizohen aktivitete nëpërmjet të cilave të nxënësit zhvillohet kultura e leximit jo vetëm në funksion të mësimit, por edhe për zhvillimin e kureshtjes, kreativitetit dhe fantazisë, e do të jetë vend i hulumtimit dhe mësimit të pavarur dhe kolaborativ, si dhe zhvillimit të arsimimit informativ dhe mediatik.

(4) Biblioteka është e arritshme dhe e qasshme për të gjithë nxënësit, duke i përfshirë edhe nxënësit me aftësi të kufizuara, ka orar pune të theksuar publikisht dhe është e hapur për numër të mjaftueshëm orësh që të mund secili nxënës ta vizitojë.

(5) Shkolla ka për detyrë në fondin e bibliotekës t'i grumbullojë librat shkollorë, mjetet mësimore të dedikuara për nxënësit, si dhe të sigurojë

lektyra për nxënësit dhe literaturë profesionale për mësime dhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë.

Programi ndërkombëtar për arsimin fillor (IB Programi)

Neni 56

(1) Në shkollë fillore mund të realizohet edhe programi ndërkombëtar për arsimin fillor (në tekstin e mëtejme: IB Programi), për çfarë pëlqim jep Ministria.

(2) Planin dhe programet mësimore për IB Programin i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(3) IB Programi është me rëndësi të njëjtë si edhe arsimit i rregullt fillor.

(4) Shkolla fillore realizon IB Program në pajtim me standardet e IB organizatës që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e programit mësimor.

(5) Shkolla fillore në të cilën realizohet IB Programi mund të ketë më së shumti tri paralele në klasë.

(6) Numri i nxënësve në paralele që e ndjekin mësimin sipas IB Programit është më së shumti deri në 24.

(7) Për nxënësit që e ndjekin mësimin sipas IB Programit, shkolla fillore organizon qëndrim të vazhdueshëm në klasën e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë.

(8) Mjetet për realizimin e IB Programit i siguron Ministria, për çfarë shkolla fillore në të cilën realizohet IB Programi çdo vit më së voni deri më 10 qershor në vitin shkollor rrjedhës, ndërsa për vitin e arshshëm shkollor në Ministri dërgon plan financiar.

(9) Mënyrën e sigurimit të mjeteve nga paragrafi (8) i këtij neni, e përcakton ministri.

(10) Shkolla fillore e cila realizon IB Program më së voni deri më 1 tetor dërgon në Ministri raport financiar për vitin shkollor paraprak.

(11) Shkolla e cila realizon IB Program (mësim klasor dhe mësim lëndor) ka për detyrë që në afat prej tri vitesh nga dita e fillimit me realizimin e IB Programit të akreditohet nga ana e IBO-së, e në bazë të së cilave do të marrë status të Shkollës Botërore IB. Nëse shkolla në afatin e theksuar nuk akreditohet i ndërpritet statusi i Shkollës IB dhe Ministria pushon të sigurojë mjete nga paragrafi (8) i këtij neni.

Neni 57

(1) Në shkollën fillore në të cilën realizohet IB Programi së paku një e katërta e numrit të përgjithshëm të mësime dhënësit të punësuar në shkollën fillore duhet të kenë njohuri të gjuhës angleze, së paku në nivelin A1 sipas Kornizës së Përbashkët Referuese Evropiane të Gjuhëve, që dëshmohet me marrjen e certifikatës.

(2) Në shkollën fillore në të cilën realizohet IB Programi ka koordinator për IB Programin i cili duhet të ketë njohuri të gjuhës angleze së paku nivelin B2 sipas Kornizës së Përbashkët Referuese Evropiane të Gjuhëve që dëshmohet me marrjen e certifikatës, së paku pesë vjet punë si mësime dhënësit dhe njohje të shkëlqyeshme të punës me kompjuterë.

(3) Nëse koordinatori nga paragrafi (2) i këtij neni, zgjidhet nga radhët e mësime dhënësit që janë në marrëdhënie të rregullt pune për periudhën

derisa i kryen detyrat e IB koordinatorit, marrëdhënia e punës mësimdhënësit në shkollë i pezullohet.

Neni 58

(1) Në shkollën fillore në të cilën realizohet IB Programi mbahet libër kryesor dhe mbahet dokumentacion dhe evidencë e veçantë pedagogjike, në pajtim me IB standardet, që përfshin: ditarin e paraleles, listat evidentuese për suksesin e nxënësve, legjitimacionin e nxënësit me suksesin e arritur në fund të gjysmëvjetorit të parë.

(2) Ditarin e paraleles mësimdhënësi e mban detyrimisht edhe në formë elektronike (e-ditar) në bazë javore, nëpërmjet ueb aplikacionit të cilën e administron Ministria.

(3) Formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike që mbahet në shkollën fillore në të cilën realizohet IB Programi nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

V. REGJISTRIMI I NXËNËSVE

Statusi i nxënësit

Neni 59

(1) Fëmija me ardhjen në shkollën fillore e merr statusin e nxënësit.

(2) Nxënësi e ndjek mësimin dhe merr pjesë në aktivitetet tjera të përcaktuara me planin dhe programet mësimore për edukimin dhe arsimin fillor.

Koha dhe moshja e regjistrimit në shkollë

Neni 60

(1) Fëmijët në klasë të parë në shkollë fillore regjistrohen në muajin maj për vitin e ardhshëm shkollor.

(2) Gjatë regjistrimit të fëmijës në klasën e parë prindi, përkatësisht kujdestari ka për detyrë të dorëzojë vërtetim për vaksinat e detyrueshme të marra për fëmijën, kontrollet oftalmologjike dhe stomatologjike, të lëshuar nga institucioni shëndetësor kompetent.

(3) Gjatë regjistrimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në klasën e parë prindi, përkatësisht kujdestari ka për detyrë të dorëzojë edhe mendim/profil funksional nga komisioni për vlerësimin e fëmijëve dhe të rinjve për mbështetjen shëndetësore, sociale dhe arsimore plotësuese sipas KNF-së.

(4) Në klasën e parë të shkollës fillore prindi, përkatësisht kujdestari ka për detyrë ta regjistrojë fëmijën që deri në fund të vitit kalendarik do të mbush gjashtë vjet.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (4) i këtij neni, fëmija mund të regjistrohet në klasën e parë, nëse i mbush gjashtë vjet deri më 31 janar vitin e ardhshëm, me kërkesë paraprake nga prindi, përkatësisht kujdestari dhe mendimit të marrë nga pedagogu ose psikologu në shkollë.

(6) Regjistrimin e fëmijës, me kërkesë të prindit, përkatësisht kujdestarit, institucioni shëndetësor mund ta prolongojë për një vit nëse konstatohet se fëmija nuk është i gatshëm të shkojë në shkollë.

(7) Fëmijët të cilët nuk janë të përfshirë në mësim, ndërsa janë me kufi të kaluar të moshës, mund të regjistrohen në shkollë fillore në pajtim me nenin 14 të këtij ligji.

Komisioni për Regjistrim në Shkollë

Neni 61

(1) Regjistrimin e fëmijës në shkollë e kryen komisioni treanëtarësh i përbërë nga pedagogu ose psikologu ose edukatori special dhe rehabilitatori dhe mësimdhënësi nga radhët e mësimdhënësve të klasës. Komisionin e formon drejtori i shkollës.

(2) Për nxënësit e regjistruar shkolla publikon listë në tabelën e shpalljes të shkollës, më së voni deri më 15 qershor.

(3) Nëse komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, për nxënësin e regjistruar vlerëson se fëmija ka pengesë të caktuar zhvillimore, me ç'rast prindi, përkatësisht kujdestari nuk ka dërguar mendim/profil funksional të trupit profesional për vlerësim, në interes të mirë të fëmijës është që komisioni ta udhëzojë prindin, përkatësisht kujdestarin të trupi profesional për vlerësim, me qëllim që të caktohen masat e nevojshme për mbështetjen në të mësuarit.

(4) Për mosregjistrim, përkatësisht për mosgatishmërinë e fëmijës për të shkuar në shkollë, komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar detyrë që me shkrim ta njoftojë prindin, përkatësisht kujdestarin më së voni deri më 15 qershor.

(5) Prindi, përkatësisht kujdestari pas njoftimit nga paragrafi (4) i këtij neni, ka të drejtë kundërshtimi në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, te komisioni i formuar nga kryetari i komunës.

(6) Regjistrimin e fëmijëve që nuk janë të përfshirë në mësim, e janë me kufi të kaluar të moshës, e kryen komisioni të cilin e formon drejtori i shkollës. Komisioni është i përbërë nga pedagogu ose psikologu dhe dy mësimdhënës klasorë.

(7) Mënyrën e regjistrimit të nxënësve nga paragrafi (6) i këtij neni, e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Prolongimi i ndjekjes së mësimi

Neni 62

(1) Gjatë vitit mësimor të nxënësit në klasën e parë, me propozim të mësimdhënësit që e udhëheq paralelen, pedagogu, edukatori special dhe rehabilitatori ose psikologu, në pajtim me prindin, përkatësisht kujdestarin, për shkaqe shëndetësore ose tjera, mund t'i prolongohet ndjekja e mësimi për një vit.

(2) Për prolongimin e ndjekjes së mësimi nga paragrafi (1) i këtij neni, vendos drejtori me propozim të komisionit, në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Komisionin nga paragrafi (2) i këtij neni, e formon drejtori i shkollës fillore dhe është i përbërë nga psikologu, pedagogu dhe edukatori special dhe rehabilitatori dhe dy mësimdhënës klasorë.

(4) Nëse shkolla nuk ka të punësuar edukator special dhe rehabilitator, anëtar të komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni, caktohet personi nga shkollat fillore me qendër të resurseve nga rajoni i komunës ku është shkolla fillore

ose nga qendrat për mbështetjen e të mësuarit, përkatësisht nga shkolla më e afërt me qendër të resurseve ose qendër për mbështetjen e të mësuarit.

(5) Prindi, përkatësisht kujdestari pas vendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, ka të drejtë ankese në komisionin e formular nga kryetari i komunës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës.

Rajonizimi i shkollave

Neni 63

(1) Prindi, përkatësisht kujdestari ka të drejtë ta regjistrojë fëmijën në shkollën fillore në rajonin në të cilin jeton ose ku ka qëndrim të përhershëm.

(2) Shkolla fillore ka për detyrë t'i përfshijë nxënësit e rajonit të vet.

(3) Prindi, përkatësisht kujdestari mund ta regjistrojë fëmijën në shkollën tjetër fillore në të njëjtin ose rajonin tjetër nëse për këtë ka pëlqim nga shkolla në të cilën regjistrohet dhe nga shkolla e rajonit në të cilin jeton ose ku ka qëndrim të përhershëm.

(4) Shkolla fillore mund t'i regjistrojë nxënësit e rajonit tjetër ose të komunës tjetër vetëm nëse ka vende të lira për regjistrim ose nëse nxënësi nga rajoni ose komuna tjetër nuk ka mundësi ta ndjekë mësimin në gjuhën e tij amtare në rajonin ose komunën e vet.

(5) Themeluesi e përcakton rajonin e shkollave fillore prej të cilave regjistrohen nxënësit në shkolla.

(6) Lista e fëmijëve nga rajoni për regjistrim në shkollën fillore merret nga shërbimet kompetente në njësinë e vetëqeverisjes lokale që mbajnë evidencë të banorëve të përhershëm dhe të përkohshëm.

(7) Listën nga paragrafi (6) i këtij neni, njësitë e vetëqeverisjes lokale e marrin nga organi kompetent për mbajtjen e librave amë të fëmijëve të lindur dhe të vdekur, si dhe nga organi kompetent për mbajtjen e evidencës për lëvizjen e qytetarëve jashtë vendit.

(8) Lista nga paragrafi (6) i këtij neni, i përmban emrin e fëmijës, emrin e nënës nga prindërit përkatësisht kujdestarët, mbiemrin e fëmijës, datën dhe vitin e lindjes së fëmijës, adresën e vendbanimit/vendqëndrimit në shtet përkatësisht nëse është jashtë shtetit.

(9) Gjatë shkollimit nxënësi mund të kalojë në shkollë tjetër fillore nëse ka pëlqim nga shkolla në të cilën kalon.

(10) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Njoftimi i inspektorit të arsimit për nxënësit e paregjstruar dhe nxënësit që mungojnë pa arsye

Neni 64

(1) Shkolla fillore ka për detyrë ta njoftojë inspektorin e autorizuar të arsimit të komunës ose inspektorin shtetëror të arsimit në komunat ku nuk ka inspektor të autorizuar të arsimit për fëmijët që nuk janë regjistruar në klasën e parë deri më 20 qershor, ndërsa për nxënësit që pa arsye nuk e ndjekin shkollën fillore më tepër se një muaj, në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i muajit.

(2) Për nxënësit që nuk janë regjistruar në shkollën fillore në pajtim me nenin 60 paragrafi (4) të këtij ligji, shkolla ka për detyrë të ndërmarrë aktivitete me qëllim të regjistrimit të tyre në shkollën fillore.

(3) Aktivitetet që i ndërmerr shkolla nga paragrafi (2) i këtij neni, janë: vizita në shtëpi e familjeve të nxënësve që nuk janë regjistruar përkatësisht nxënësve që pa arsye nuk e ndjekin shkollën fillore më tepër se një muaj, bashkëpunimi me organizatat qytetare që punojnë për zvogëlimin e diskriminimit, segregacionit dhe izolimit, edukimi i prindërve përkatësisht kujdestarëve, dita e hapur informative e shkollës.

VI. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E NXËNËSVE

Mbrojtja e integritetit të nxënësve

Neni 65

(1) Çdo i punësuar në shkollë ka për detyrë të kujdeset për interesin më të mirë të nxënësit dhe ta respektojë dinjitetin e tij, si dhe Konventën për të drejtat e fëmijës.

(2) Ndalohet abuzimi trupor, psikik dhe seksual dhe dënimi i nxënësit dhe sjellja dhe veprimi nënçmues ndaj tij.

Parandalimi i dhunës ndaj nxënësve

Neni 66

(1) Drejtori i shkollës obligohet që ta paraqesë çdo formë të dhunës, keqpërdorimit ose anashkalimit të kryer ndaj nxënësit nga nxënësi tjetër, prindi përkatësisht kujdestari, mësimdhënësi, bashkëpunëtori profesional ose cilido person tjetër i punësuar në shkollë, te organet kompetente të përcaktuara me ligj.

(2) Procedura për paraqitje dhe mbrojtje të nxënësit-viktimë nga cilado formë e dhunës, keqpërdorimit ose anashkalimit përcaktohen me akt nënligjor.

(3) Aktin nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni, me propozim të Byrosë e miraton ministri.

E drejta dhe obligimi që të ndiqet mësimi dhe puna edukativo-arsimore

Neni 67

(1) Nxënësi ka të drejtë dhe obligim ta ndjekë mësimin dhe të marrë pjesë në punën edukativo-arsimore që e organizon shkolla fillore.

(2) Nxënësi ka për obligim të veprojë në pajtim me rregullat për sjellje në shkollë të parapara në rendin shtëpiak, rregullisht ta ndjekjë mësimin dhe t'i përmbushë obligimet dhe detyrat e planifikuara që parashihen me planin dhe programet mësimore dhe programin vjetor për punë.

Organizimi dhe pjesëmarrja e nxënësve

Neni 68

(1) Të gjithë nxënësit në shkollë e përbëjnë bashkësinë e shkollës. Nxënësit kanë të drejtë të organizimit të nxënësve në nivel të paraleles dhe shkollës.

(2) Mënyra e organizimit të nxënësve nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullohet me statutin e shkollës.

(3) Për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore, nxënësit organizohen në bashkësi të paraleles dhe parlament të nxënësve.

(4) Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e bashkësive të paraleleve.

(5) Konvokimin e parë të parlamentit të nxënësve e bën drejtori i shkollës.

(6) Parlamenti i nxënësve:

- merr pjesë në mënyrë aktive në përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve,

- e promovon aktivizmin e nxënësve,

- merr pjesë në aktivitetet për sigurimin e mbështetjes së moshatarëve të nxënësve me nevojat e veçanta arsimore, në realizimin e mësimin dhe aktivitetet jashtëmësimore,

- merr pjesë në përpilimin e programit vjetor për punë,

- jep propozim-aktivitete për programet për ekskursionet vjetore,

- jep propozime për aktivitetet jashtëmësimore të shkollës,

- jep propozime për përmirësimin e standardit të nxënësve,

- merr pjesë në evalvimin e punës së shkollës,

- nëpërmjet përfaqësuesve të vet merr pjesë në këshillin e prindërve dhe këshillin e mësimdhënësve dhe

- organizon dhe marrin pjesë në aktivitete humanitare, aktivitetet ekologjike dhe punën e dobishme shoqërore.

(7) Kryetari i parlamentit të nxënësve zgjidhet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të kryetarëve të bashkësive të paraleleve nëpërmjet votimit të fshehtë.

(8) Avokati i nxënësve kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve në shkollë. Avokati i nxënësve zgjidhet me shumicë votash nga nxënësit e klasës së shtatë deri në klasën e nëntë, nëpërmjet votimit të fshehtë.

Lirimi nga aktivitetet e veçanta

Neni 69

Nxënësi për shkaqe shëndetësore mund të lirohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e veçanta në mësim në shkollën fillore, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga institucioni shëndetësor përkatës.

Mungesat nga mësimi

Neni 70

(1) Për çdo mungesë të nxënësit nga mësimi prindi përkatësisht kujdestari ka për detyrë ta njoftojë udhëheqësin e paraleles për shkaqet e mungesës.

(2) Nxënësi mund të mungojë nga mësimi nëse mungesën e tij prindi ose kujdestari e paralajmëron në shkollë, por jo më tepër se pesë ditë në vitin mësimor.

(3) Drejtori i shkollës me kërkesë me shkrim prindërve përkatësisht kujdestarëve për shkaqe të arsyeshme mund t'i lejojë nxënësit mungesë më të gjatë nga mësimi, por jo më gjatë se 30 ditë.

Vazhdimi i obligimit për arsimin fillor

Neni 71

(1) Nxënësi i cili i ka mbushur 16 vjet, ndërsa ende nuk e ka mbaruar shkollën fillore, e vazhdon arsimin në kuadër të programit për arsimin fillor për të rritur.

(2) Nxënësi nga paragrafi (1) i këtij neni, e mban statusin e nxënësit, në pajtim me ligjin.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse nxënësi është në vitin e fundit në arsimin fillor atëherë arsimin e vazhdon në kuadër të shkollës ku e ka ndjekur mësimin.

Masat pedagogjike

Neni 72

(1) Ndaj nxënësit i cili nuk i kryen obligimet dhe i shkel rregullat e punës edukativo-arsimore zbatohen masat pedagogjike si vijojnë: vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, qortim, zhvendosje e nxënësit në paralele tjetër dhe zvogëlim i sjelljes.

(2) Njëkohësisht me shqiptimin e masave pedagogjike nga paragrafi (1) i këtij neni, drejtori i shkollës formon ekip për mbështetje që do të punojë me prindin, përkatësisht kujdestarin, nxënësin, mësimdhënësin dhe paralelen, me qëllim të tejkalimit të problemit. Ekipi për mbështetje është i përbërë nga dy përfaqësues nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional dhe një mësimdhënës. Shkolla mund të ftojë edhe persona të tretë, (punëtor social) që të marrin pjesë në ekipin për mbështetje.

(3) Mënyrën e shqiptimit të masave pedagogjike e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

E drejta e transportit falas

Neni 73

(1) Nxënësi ka të drejtë të transportit të organizuar ose falas nëse vendbanimi është larg së paku dy kilometra nga shkolla më e afërt fillore.

(2) Nxënësit me aftësi të kufizuara dhe personat për shoqërimin e tyre kanë të drejtë të qasjes së transportit falas pa marrë parasysh largësinë dhe qasjen e vendbanimit të tyre deri në shkollën fillore.

Shujta në shkolla

Neni 74

(1) Shkolla fillore, në marrëveshje me prindërit përkatësisht kujdestarët, e në pajtim me rregullat në fushën e prokurimeve publike, mundet për të gjithë nxënësit të organizojë së paku një shujtë gjatë kohës së qëndrimit në shkollë.

Shpenzimet për shujtë i paguan prindi, përkatësisht kujdestari. Në rastet kur prindi, përkatësisht kujdestari është pranues i ndihmës së garantuar minimale, shpenzimet për shujtë mund t'i kompensojë themeluesi.

(2) Standardet për ushqimin dhe për shujtat në shkollë i përcakton Ministria, në bashkëpunim me institucionin profesional përkatës. Cilësinë nutritive të ushqimit dhe shujtave i përcakton Instituti i Shëndetit Publik dhe Qendrat e Shëndetit Publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Drejtori i shkollës fillore ka për detyrë ta ndjekë sigurimin e standardeve për ushqimin dhe për shujtat në shkollat fillore nga paragrafi (2) i këtij neni, dhe për parregullsitë e vërejtura t'i njoftojë shërbimet kompetente nga paragrafi (5) i këtij neni, menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e konstatimit të parregullsive.

(4) Këshilli i Prindërve mund të kërkojë mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese nëse në shkollën fillore shujtat janë në pajtim me standardet e ushqimit.

(5) Mbikëqyrjen inspektuese për ndjekjen e standardeve të përcaktuara për ushqimin dhe për shujtat në shkollat fillore nga paragrafi (2) i këtij neni, e kryejnë Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Inspektorati Shëndetësor dhe Sanitar Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik dhe Qendrat e Shëndetit Publik, në pajtim me ligjin.

(6) Për parregullsitë e konstatuara gjatë zbatimit të standardeve për ushqimin dhe për shujtat në shkollat fillore dhe masat e ndërmarra, organet kompetente nga paragrafi (5) i këtij neni, e njoftojnë drejtorin e shkollës, komunën, Ministrinë dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

Diploma, fletëlavdërime dhe shpërblime

Neni 75

(1) Nxënësit të cilët dallohen me njohurinë e tyre ose me lloje tjera të arritjeve, shkolla fillore i lavdëron, përkatësisht i shpërblen.

(2) Nxënësve që arrijnë rezultate mbi mesatare në lëndë të caktuara mësimore ose aktivitete jashtëmësimore, shkolla fillore, me propozim të këshillit të mësimdhënësve, u lëshon diploma dhe fletëlavdërime të veçanta.

(3) Në fund të klasës së nëntë shkolla mund t'u lëshojë diplomë për të parin e gjeneratës më së shumti tre nxënësve.

(4) Formën dhe përmbajtjen e diplomave, si dhe mënyrën e lëshimit të tyre e përcakton ministri me propozim të Byrosë.

Këshillimi i prindërve, përkatësisht kujdestarëve

Neni 76

Prindi, përkatësisht kujdestari dërgohet në këshillim, nëse:

- nxënësi gjatë vitit mësimor njëkohësisht ka notë negative në tri ose më tepër lëndë,

- nxënësi ka bërë më tepër se dhjetë mungesa të paarsyeshme,

- nxënësi e ofendon mësimdhënësin,

- nxënësi merr pjesë në forma të ndryshme të dhunës,

- nxënësi shfaq sjellje antisociale (devijuese) dhe asociale,

- nxënësi para kohe e lëshon arsimin,

- nxënësi e shfrytëzon gjuhën e urrejtjes dhe

- në periudhë të shkurtër nxënësit dukshëm i zvogëlohet suksesi.

Procedura e këshillimit të prindërve, përkatësisht kujdestarëve

Neni 77

(1) Kujdestari i klasës, përkatësisht i paraleles fton në këshillim së paku një prind, përkatësisht kujdestar, me ftesë të dërguar nëpërmjet telefonit, me postë ose me dërgesë personale.

(2) Nëse ftesa për këshillim ka të bëjë me sjelljen antisociale (devijuese) dhe asociale të nxënësit, para se të dërgohet ftesa kërkohet mendimi profesional nga Shërbimi Pedagogjik.

(3) Shërbimi Pedagogjik, në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i kërkesës dorëzon mendim profesional për sjelljen e nxënësit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Ftesa për këshillimin e prindit, përkatësisht kujdestarit duhet të jetë e numërtuar dhe të dërgohet së paku tetë ditë para mbajtjes së këshillimit.

(5) Nëse prindi, përkatësisht kujdestari për shkaqe të arsyeshme nuk mund t'i përgjigjet ftesës ka për detyrë që për mungesën ta njoftojë kujdestarin e klasës, përkatësisht paraleles, para mbajtjes së këshillimit ose në afat prej tre ditësh pas këshillimit.

(6) Kujdestari i klasës, përkatësisht paraleles e njofton psikologun, përkatësisht pedagogun në shkollë për ftesën e dërguar për këshillimin e prindit, përkatësisht kujdestarit.

(7) Psikologu, përkatësisht pedagogu i shkollës përpilon plan javor dhe mujor për mbajtjen e këshillimit.

(8) Me nxënësit prindërit, përkatësisht kujdestarët e të cilëve janë dërguar në këshillim për shkak të veprimeve të nxënësit nga paragrafi 76 i këtij ligji, psikologu, përkatësisht pedagogu realizon këshillim të nxënësit, pas përfundimit të këshillimit të prindërve, përkatësisht kujdestarëve, në pajtim me Programin për këshillimin e nxënësve dhe prindërve, përkatësisht kujdestarëve, që me propozim të Shërbimit Pedagogjik, e përcakton ministri.

Mënyra e kryerjes së këshillimit të prindërve, përkatësisht kujdestarëve

Neni 78

(1) Këshillimin nga neni 77 të këtij ligji, sipas rregullit, e kryen psikologu, përkatësisht pedagogu në shkollë.

(2) Në këshillimin e prindit, përkatësisht kujdestarit edhe psikologu, përkatësisht pedagogu ka për detyrë të veprojnë në pajtim me Programin nga neni 77 paragrafi (8) i këtij ligji.

(3) Për këshillimin e mbajtur nga paragrafi (2) i këtij neni, psikologu, përkatësisht pedagogu mban procesverbal dhe listë të pjesëmarrjes.

VII. TË PUNËSUARIT NË SHKOLLË FILLORE

Personat që realizojnë punë edukativo-arsimore

Neni 79

(1) Punën edukativo-arsimore në shkollën fillore e realizojnë mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë (pedagogu, psikologu,

edukatori special dhe rehabilitatori, sociologu, punëtori social, bibliotekisti etj.).

(2) Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë punën edukative arsimore e realizojnë në pajtim me ligjin.

Llojet e vendeve të punës në shkolla fillore

Neni 80

Në shkollë fillore vendet e punës të të punësuarve janë:

- nëpunës administrativë,
- dhënësit e shërbimeve publike në arsimin fillor dhe
- personat ndihmës-teknikë.

Nëpunësit administrativë në shkolla fillore

Neni 81

(1) Të punësuarit në shkollat fillore që kryejnë punë të natyrës administrative për realizimin e veprimtarisë së arsimit fillor kanë status të nëpunësve administrativë dhe për ta zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligjit për nëpunës administrativë dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet nivelet e vendeve të punës si vijojnë:

- kategoria V – profesionale,
- niveli V1 këshilltar për punët juridike normative (sekretar) dhe këshilltar për punët e kontabilitetit (kontabilist),
- kategoria G – ndihmës-profesionale,
- niveli G1 referent i pavarur (sekretar teknik i cili kryen punë të arkëtarit, dhe punë tjera të ngjashme, arkëtar i cili kryen punë administrative dhe të ngjashme) dhe
- niveli G2 referent i lartë (arkëtar, sekretar teknik dhe të tjerë).

Dhënës të shërbimeve publike arsimin fillor

Neni 82

(1) Të punësuarit në shkollat fillore të cilët kryejnë punë edukativo-arsimore në veprimtarinë e arsimit fillor, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsimin fillor dhe punësohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme.

(2) Për të punësuarit e tjerë që janë dhënës të shërbimeve publike, ndërsa nuk punësohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme përcaktohet kategoria dhe niveli i vendeve të punës si vijon:

- kategoria M edukues dhe
- niveli M1 edukues.

(3) Për të punësuarit nga paragrafi (2) i këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji, rregullat në fushën e të punësuarve në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Personat ndihmës-teknikë në shkolla fillore

Neni 83

(1) Të punësuarit në shkollat fillore që kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të personave ndihmës-teknikë dhe për ta zbatohen dispozitat e këtij ligji, rregullat në fushën e të punësuarve në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen nëngrupet, kategoritë dhe nivelet e vendeve të punës si vijon:

- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 pastrues, fokist-menaxhues me kaldajat e ngrohjes, ekonom-nikoqir, mjeshtër shtëpiak dhe tjetër,
- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar dhe tjetër,
- nëngrupi 3 kategoria A niveli A1 shofer dhe tjetër,
- nëngrupi 4 kategoria A niveli A1 kamariere-enëlarëse, kuzhinier dhe tjetër dhe
- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 punëtor i përgjithshëm, larëse, përkëdhelës dhe tjetër.

Plani vjetor për punësim në shkolla fillore

Neni 84

Drejtori i shkollës fillore përpilon plan vjetor për punësim në shkollën fillore për vitin e ardhshëm, në pajtim me rregullat në fushën e të punësuarve në sektorin publik.

Kushtet për punësim në shkollë fillore

Neni 85

(1) Dhënësit e shërbimeve publike punësohen në pajtim me këtë ligj, Ligjin për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë në shkollat fillore dhe të mesme, rregullat në fushën e të punësuarve në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(2) Nëpunësit administrativë në shkollat fillore punësohen në formë të konkursit publik në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(3) Personat ndihmës-teknikë në shkollat fillore punësohen në formë të konkursit publik në pajtim me rregullat në fushën e të punësuarve në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(4) Gjatë zgjedhjes së personave ndihmës-teknikë zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive dhe respektimi i kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës.

(5) Personat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, të cilët punësohen në vendet e përhershme të punës të zbratura në bazë të pensionimit, sëmundjes, dorëheqjes, vdekjes, sistematizimit ose tjetër, ndërsa për të cilat vende të punës ishin siguruar mjetet financiare, mund të themelojnë marrëdhënie pune edhe pa konkurs publik, në kohë të caktuar, më së shumti deri më tre muaj me pëlqim të kryetarit për shkollat fillore komunale përkatësisht ministrit për shkollat fillore shtetërore.

Edukuesi

Neni 86

(1) Edukues mund të punësohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme i përmbush edhe kushtet e veçanta si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të ketë arsim përkatës në pajtim me normativin për edukues,
- e njuh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën dhe alfabetin në të cilën realizohet mësimi dhe
- ta ketë dhënë provimin profesional për edukues.

(2) Drejtori i shkollës fillore formon komision të përbërë prej tre anëtarëve nga radha e kuadrit edukativo-arsimor i cili kryen kontroll të njohurive të gjuhës së edukuesve nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç nëse edukuesi është mësimdhënës i lëndës së gjuhës maqedonase.

(3) Në shpallje publike për themelimin e marrëdhënies së punës për edukator mund të paraqitet edhe personi pa dhënien e provimit profesional dhe të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar deri në përfundimin e vitit shkollor.

(4) Pa dhënien e provimit profesional nuk mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të pacaktuar.

(5) Normativin nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni, e përcakton ministri me propozim të Byrosë.

Konkursi publik për punësim

Neni 87

(1) Edukuesin e zgjedh drejtori i shkollës, në formë të shpalljes publike dhe themelon marrëdhënie pune në kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

(2) Edukuesit të cilët punësohen në vendet e përhershme të punës të zbrazura në bazë të pensionimit, sëmundjes, dorëheqjes, vdekjes, sistematizimit ose tjetër, ndërsa për të cilat vende të punës ishin siguruar mjetet financiare, mund të themelojnë marrëdhënie pune edhe pa konkurs publik, në kohë të caktuar, më së shumti deri më tre muaj me pëlqim të kryetarit për shkollat fillore komunale përkatësisht ministrit për shkollat fillore shtetërore.

(3) Konkursi publik nga paragrafi (1) i këtij neni, botohet në së paku dy gazeta ditore nga të cilat së paku në njërin nga gazetatat që botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Shkolla fillore, para se të shpall konkurs publik për punësim, nevojën e edukuesit në kohë të caktuar e siguron me dukues me arsim përkatës me fond jo të plotë të orëve të punës nga shkolla tjetër publike në komunën pas pëlqimit të siguruar për punësim në kohë të caktuar të punës nga Ministria.

Punësimi në kohë të caktuar

Neni 88

Asistentët nga neni 19 paragrafi (1) të këtij ligji, themelojnë marrëdhënie pune në kohë të caktuar, më së shumti deri në fund të vitit shkollor.

Transformimi i marrëdhënies së punës

Neni 89

(1) Në veprimtarinë e arsimit fillor transformimi i marrëdhënies së punës nga koha e caktuar në kohë të pacaktuar është e lejuar vetëm nëse:

- edukuesi ka përvojë pune më tepër se dy vjet në institucionin edukativo-arsimor të verifikuar nga ministria, me ndërprerje ose pa ndërprerje,
- edukuesi është në vend pune për të cilën kërkohet transformimi, i zbrazur në bazë të pensionimit, dorëheqjes, vdekjes ose bazave tjera dhe janë siguruar mjetet financiare,
- edukuesi i përmbush kushtet e parapara në normativin për edukues,
- punëdhënësi përcakton se ka nevojë të përhershme nga edukuesi dhe kjo nuk do të shkaktojë tepricë teknologjike,
- edukuesi e ka dhënë provimin profesional dhe
- është marrë pëlqimi për transformim të marrëdhënies së punës nga Ministria.

(2) Kërkesën për transformimin e marrëdhënies së punës, shkolla e dërgon te komisioni për transformimin e marrëdhënies së punës (në tekstin e mëtejme: komisioni i transformimit), të cilin e formon kryetari i komunës, përkatësisht ministri për shkollat fillore shtetërore dhe është i përbërë prej tre anëtarëve, edhe atë: nga një anëtar të komunës, përkatësisht Ministrisë, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe sindikatës reprezentative të arsimit. Kryetari i komisionit të transformimit është përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

(3) Komisioni i transformimit formohet për periudhën prej tre vitesh.

(4) Në kërkesën për transformimin e marrëdhënies së punës, shkolla te komisioni i transformimit dërgon:

- raport për përvojën e realizuar të punës nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- deklaratë të drejtorit të shkollës se vendi i përhershëm i punës për të cilin kërkohet transformimi është i zbrazur në bazë të pensionimit, dorëheqjes, vdekjes ose bazave tjera dhe janë siguruar mjetet financiare,
- deklaratë të drejtorit të shkollës se ka nevojë të përhershme nga personi dhe nuk do të shkaktojë tepricë teknologjike,
- kopje të diplomës / certifikatës për mbarimin e arsimit përkatës në pajtim me normativin,
- kopje të certifikatës për dhënien e provimit profesional dhe
- analizë të vendeve të punës në nivel të shkollës.

(5) Komisioni i transformimit kryen kontroll të provave nga paragrafi (4) i këtij neni dhe përpilon raport me propozim për transformimin vetëm të personave që i përmbushin kushtet për transformimin e marrëdhënies së punës. Raporti me propozimin nevojitet të përmbajë edhe analizë të vendeve të punës në nivel të shkollës dhe të komunës dhe ai detyrimisht duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të transformimit.

(6) Komisioni i transformimit për shkollat fillore komunale raportin me propozimin nga paragrafi (5) i këtij neni, e dërgon në Ministri.

(7) Edukuesve të cilët nuk i përmbushin kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni i transformimit ua kthen dokumentet e shkollës me arsyetimin, në afat prej shtatë ditësh nga dita e shqyrtimit të tyre.

(8) Drejtori i shkollës fillore në bazë të njoftimit nga paragrafi (7) i këtij neni, në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së njoftimit, miraton vendim për refuzimin e transformimit të marrëdhënies së punës.

(9) Edukuesi i cili nuk është i kënaqur nga vendimi nga paragrafi (8) i këtij neni, ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(10) Ministria në bazë të raportit me propozimin nga paragrafi (5) i këtij neni, për personat që i përmbushin kushtet për transformim të marrëdhënies së punës jep pëlqim për transformimin e marrëdhënies së punës.

(11) Drejtori i shkollës fillore në bazë të pëlqimit të dhënë nga paragrafi (10) i këtij neni, në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së pëlqimit, miraton vendim për transformimin e marrëdhënies së punës.

Siguria dhe shëndeti gjatë punës së të punësuarve në shkollë fillore

Neni 90

Të punësuarit në shkollë fillore, në pajtim me rregullat në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, duhet të kontrollohen në mënyrë sistematike.

Të drejtat gjatë pushimit të marrëdhënies së punës

Neni 91

Edukuesit për punën e të cilëve ka pushuar nevoja për shkaqe afariste, nuk mund t'i pushojë marrëdhënia e punës, derisa nuk i sigurohet njërat nga të drejtat në pajtim me rregullat e përgjithshme në fushën e marrëdhënies së punës dhe Marrëveshjen kolektive për arsimin fillor.

VIII. DOKUMENTACIONI DHE EVIDENCA PEDAGOGJIKE DHE PËRMBLEDHJET E TË DHËNAVE

Lloje të dokumentacionit pedagogjik

Neni 92

(1) Shkolla fillore grumbullon, përpunon, ruan, ndërmjetëson dhe përdor të dhëna që i përmban dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.

(2) Dokumentacioni pedagogjik në aspekt të këtij ligji përfshin: librin kryesor të nxënësve, fletët e evidencës për suksesin e nxënësve, legjitimacionin e nxënësve, dëftesën, shtojcën e dëftesës dhe dokument transferimi të nxënësve.

(3) Libri kryesor i nxënësve është dokument me vlefshmëri të përhershme.

Mënyra e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik

Neni 93

(1) Dokumentacioni pedagogjik nga neni 92 paragrafi (2) i këtij ligji, mbahet dhe shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

(2) Për nxënësit pjesëtarë të bashkësive të cilët mësimin e realizojnë në gjuhë dhe alfabet ndryshe prej gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, dokumentacioni pedagogjik nga paragrafi (1) i këtij neni, mbahet dhe shtypet në gjuhë maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

(3) Ditari i paraleles mbahet në gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

(4) Në shkolla mbahet edhe ditar elektronik (e-ditar) në bazë javore, nëpërmjet ueb aplikacionit të cilin e administron Ministria.

(5) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit dhe evidencën pedagogjike i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Dokumente publike të cilat i lëshon shkolla fillore

Neni 94

(1) Dëftesa, shtojca e dëftesës, legjitimacioni për nxënës dhe dokumenti për kalim janë dokumente publike.

(2) Dokumentet publike shtypen në një ekzemplar. Në rast se dokumenti i lëshuar nga paragrafi (1) i këtij neni, të humbet ose shkatërrohet, shkolla fillore lëshon ekzemplar të ri duplikat.

(3) Shkolla është e obliguar të lëshojë dokument të ri me të dhëna të ndryshuara në pajtim me aktvendimin nga organi kompetent.

(4) Nxënësi që ka humbur dëftesën mund të kërkojë lëshim të dokumentit në procedurë të jashtëkontestimore pranë gjykatës kompetente në zonën e të cilës është zyra apo çfarë do zyre e shkollës fillore, nëse shkolla fillore që e mban dokumentacionin nuk mund të lëshojë ekzemplar të ri.

Qëllime për mbajtje të përmbledhjes së të dhënave

Neni 95

(1) Shkolla fillore grumbullon, përpunon, ruan, ndërmjetëson dhe përdor të dhëna që gjenden në përmbledhjet e të dhënave në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, për nevojat e bazës së integruar të të dhënave të cilën e mban Ministria.

(2) Përmbledhjet e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, mbahen për qëllimet në vijim:

- avancim i proceseve dhe procedurave të nevojshme për menaxhimin me resurset njerëzore, financat dhe infrastrukturën në shkollat fillore,

- sigurim i të dhënave të sakta, të plota, konzistente dhe me kohë që do të paraqesin mbështetje të procesit të miratimit të vendimeve, zbatimit të politikës arsimore dhe planifikimit të reformave në arsimin fillor.

- sigurim i të dhënave të domosdoshme për funksionim të ndonjë nënsistemi tjetër (ditar elektronik) në arsimin fillor dhe

- menaxhim efikas me shpërndarjen e mjeteve në sistemin e decentralizuar arsimor, planifikimin e ndërtimit dhe rikonstruktimit të infrastrukturës shkollore dhe avancimin e zhvillimit profesional të punonjësve në shkollat fillore.

(3) Për realizim të qëllimeve nga paragrafi (2) i këtij neni, ministri mund të nënshkruajë marrëveshje për shkëmbim të të dhënave me organizata vendase dhe ndërkombëtare, institucione dhe organe të administratës shtetërore, në pajtim me dispozitat nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.

Llojet e përmbledhjeve të të dhënave

Neni 96

(1) Në arsimin fillor mbahen këto përmbledhje të të dhënave:

- përmbledhje e të dhënave për nxënës të regjistruar në arsimin fillor,
- përmbledhje e të dhënave për fëmijë që janë në moshë shkollore, ndërsa nuk janë të regjistruar në shkollë,
- përmbledhje e të dhënave për prindër, përkatësisht kujdestarë të nxënësve të regjistruar në arsimin fillor,
- përmbledhje e të dhënave për të punësuarit në shkollën fillore.

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, azhurnohen me çdo ndryshim të të dhënave, ndërsa së paku një herë në nivel vjetor.

Përmbajtja e përmbledhjeve të të dhënave

Neni 97

(1) Përmbledhja e të dhënave për nxënësit e regjistruar në shkollë fillore nga neni 96 paragrafi (1) alineja 1 e këtij ligji, përfshin: numrin unik amë të qytetarit (NUAQ), mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e nxënësit, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, përkatësinë në bashkësi, gjuhën amtare e nxënësit, adresën, vendbanimin, telefonin për kontakt dhe adresën elektronik të prindit, përkatësisht kujdestarit, pengesën, statusin e nxënësit (nxënës i rregullt, nxënës i cili para kohe ka braktisur arsimin dhe shkakun për braktisjen).

(2) Përmbledhja e të dhënave për fëmijët të cilën nuk janë të regjistruar në shkollë fillore nga neni 96 paragrafi (1) alineja 2 e këtij ligji, përfshin: NUAQ, mbiemrin, emrin e babait, emrin e nënës dhe emrin e fëmijës, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, adresën, komunën ku jeton, vendbanimin, shkaqet për mosregjistrim të fëmijës, masat që janë ndërmarrë në lidhje me mosregjistrimin.

(3) Përmbledhja e të dhënave për prindër, përkatësisht kujdestarë të nxënësve të regjistruar në shkollë fillore nga neni 96 paragrafi (1) alineja 3 e këtij ligji, përfshin: lidhjen familjare me nxënësit, emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, përkatësinë në bashkësi, adresën dhe vendbanimin, telefonin për kontakt, e-mail adresën dhe shkallën e arsimimit.

(4) Përmbledhja e të dhënave për të punësuarit në shkollë nga neni 96 paragrafi (1) alineja 4 e këtij ligji, përfshin: NUAQ, mbiemrin, emrin e babait dhe emrin e të punësuarit, gjininë, përkatësinë në bashkësi, datën dhe vendin e lindjes, adresën, vendbanimin, komunën, adresën e përkohshme dhe vendbanimin e, shtetësinë, llojin dhe shkallën e arsimimit, shkollën/fakultetin e fundi të mbaruar, përvojën e punës paraprake, kategorinë e të punësuarit, vendin e punës me fond të orëve, telefonin për kontakt, numrin i telefonit zyrtar, adresën elektronike, pengesën, njësinë rajonale të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut

(FSSH), numër nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë së Veriut (FSPI) datën e punësimit, datën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, bazën për ndërprerje të marrëdhënies së punës, statusin e të punësuarit (në kohë të pacaktuar/të caktuar).

(5) Të dhënat personale nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, shkolla fillore i merr nga prindërit, përkatësisht kujdestarët e nxënësve, ndërsa të dhënat personale nga paragrafi (4) i këtij neni, i merr nga të punësuarit në shkollë.

(6) Për ndryshimin e ndodhur në përmbledhjen e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, në rast të shkakut të përcaktuar për lëshimin e procesit edukativ arsimor të nxënësi, posaçërisht në rast kur nxënësi ka krijuar bashkësi jashtëmartsore, shkolla obligohet që ta njoftojë qendrën kompetente për punë sociale, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe personin përgjegjës të arsimit në komunë në afat prej tri ditësh nga dita e paraqitjes së ndryshimit nga ana e prindit përkatësisht kujdestarit, për procedimin e tij në pajtim me ligjin.

Sistemi informativ “Observatorium i shkathtësive”

Neni 98

(1) Në Ministrinë vendoset Sistemi informativ “Observatorium i shkathtësive” (në tekstin e mëtejme: Observatorium i shkathtësive) në të cilin mbahet përmbledhje e të dhënave për nxënësit.

(2) Përmbledhja e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, mbahen për qëllimet në vijim:

- sigurim i informatave në lidhje me programet që i ofron arsimit fillor, si dhe arsimit fillor për të rritur,

- përkrahje e zhvillimit të politikës nëpërmjet sigurimit të prapavijës përkatëse analitike dhe informatike të institucioneve për arsim fillor, programet e tyre dhe performansat,

- ndihmë të prindërve përkatësisht kujdestarëve dhe nxënësve në zgjedhjen e profesionit dhe shkollave përkatëse, me qëllim të rritjes së mundësisë për punësimin e tyre në të ardhmen dhe

- qasje tek informatat për shkallën e punësimit në profesione të caktuara, koha e pritje për punësim, niveli i të ardhurave sipas profilit arsimor dhe ngjashëm.

Përmbledhje e të dhënave për nxënësit për nevojat e Observatoriumit të shkathtësive

Neni 99

(1) Të dhënat për nxënësit për nevojat e Observatoriumit të shkathtësive sigurohen nga sistemet informative të Ministrisë, Sistemi informativ për Menaxhim Arsimor (SIMA), ditar elektronik (e-ditar) dhe Sistemi elektronik për punë administrative të shkollave (SEPASH), edhe atë: NVAQ, emri, mbiemri, gjinia, emri i shkollës fillore, data e regjistrimit, data e çregjistrimit, data e mbarimit, kohëzgjatja e vitit shkollor, përkatësi në bashkësi, viti shkollor, data e lindjes.

(2) Përmbledhja e të dhënave për nxënësit, të grumbulluara për nevojat e Observatoriumit të shkathtësive mbahen tre vite pas grumbullimit të tyre në sistemin informativ të Ministrisë.

Sigurimi i të dhënave për Observatoriumin e shkathtësive

Neni 100

Për nevojat e Ministrisë, të dhënat në Observatoriumin e shkathtësive, sigurohen nga institucionet në vijim:

- Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (NUAQ, emri, mbiemri, gjinia, përkatësi në bashkësi, përvoja e punës, data e punësimit të parë, punëdhënësit paraparak, punëdhënës aktual, pagë mujore),

- Drejtoria e të Ardhurave Publike (NUAQ), emri, mbiemri, gjinia, përkatësia në bashkësi, lartësi e pagës mujore),

- Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut (NUAQ, emri, mbiemri, përkatësia në bashkësi, gjinia, status-kod (i punësuar, i papunësuar, status i panjohur), data e punësimit të fundit, pagë mujore, veprimtari e kompanisë, emri i kompanisë, vendi i punës (kode),

- institucione të akredituara për arsim të lartë (NUAQ, emri, mbiemri, gjinia, emri i fakultetit, emri i universitetit, cikli i studimeve (deridiplomike, pasdiplomike, doktoraturë), data e regjistrimit, data e çregjistrimit, data e diplomimit, titulli pas diplomimit, gjinia, kohëzgjatja e studimeve, klasifikimi në fushat shkencore hulumtuese, plani mësimor, përkatësi në bashkësi, vit akademik),

- Qendra për Arsim të të Rriturve (të dhëna statistikore),

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (të dhëna statistikore),

- Qendra për Arsim dhe Trajnim Profesional (të dhëna statistikore) dhe

- Enti Shtetëror për Statistikë (të dhëna statistikore).

Ueb Portali për Observatorium të Shkathtësive

Neni 101

(1) Observatorium i shkathtësive është sistem informativ me portal të bazuar në ueb, të cilin e mban dhe administron Ministria.

(2) Për qëllimet e paraqitura në nenin 98 paragrafi (2) i këtij ligji, qasje në raportet statistikore dhe qasje në raportet të arritshme për publikun mund t'u sigurohet:

- shkollave fillore,

- shkollave të mesme,

- Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale,

- Qendrës për Arsim të të Rriturve,

- Qendrës për Arsim dhe Trajnim profesional,

- Entit Shtetëror për statistikë,

- Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

- institucioneve të akredituara për arsim të lartë.

Të drejtat e të punësuarit apo prindit përkatësisht kujdestarit në lidhje me përmbledhjet e të dhënave

Neni 102

(1) Prindi, përkatësisht kujdestari ose i punësuar në shkollën, në rast të ndryshimit të të dhënave është i obliguar ta informojë shkollën në afat prej shtatë ditëve nga dita e ndryshimit të bërë, ndërsa shkolla është e obliguar në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të njoftimit të bëjë ndryshim në përmbledhjen e të dhënave.

(2) Prindi, përkatësisht kujdestari apo i punësuar në shkollë kanë të drejtë për qasje të të dhënave personale të përfshira në nenet 97 dhe 99 të këtij ligji, si dhe të pranojnë dokument ose ta kopjojnë informatën për të dhënave personale.

(3) Prindi, përkatësisht kujdestari apo i punësuar në shkollë kanë të drejtë të kërkojnë korrigjim të të dhënave personale, me parashtrim të kërkesës me shkrim në shkollë.

(4) Shkolla është e obliguar në afat prej 30 ditëve nga pranimi i kërkesës të bëjë korrigjim dhe ta informojë prindin përkatësisht kujdestarin, përkatësisht të punësuarin në shkollë për korrigjimin e bërë.

Personi i autorizuar për përpunim të të dhënave personale

Neni 103

(1) Drejtori i shkollës fillore, nga radhët e të punësuarve në shkollë autorizon person, përkatësisht persona për përpunimin e të dhënave personale nga nenet 97 dhe 99 të këtij ligji.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë për obligim të dhënave personale t'i ruajnë në fshehtësi. Te të dhënave personale qasje mund të kenë edhe persona tjerë profesionalë të autorizuar nga ministri, të cilëve këto të dhëna u nevojiten për shkak të ditarit elektronik, në pajtim me ligjin.

Shfrytëzimi, publikimi dhe ruajtja e të dhënave personale

Neni 104

(1) Për qëllimet e hulumtimeve shkencore dhe përgatitje të analizave statistikore, të dhënave personale mund të përdoren, të publikohen dhe ruhen, por jo në formë që mundëson identifikim të personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënave personale.

(2) Përmbledhja e të dhënave për nxënësit dhe përmbledhja e të dhënave për prindër, përkatësisht kujdestarë të nxënësve të cilat i mban shkolla fillore, mbahen katër vite pas përfundimit të arsimit fillor të nxënësit, përkatësisht dy vite pas çregjistrimit të tij nga shkolla fillore.

(3) Përmbledhja e të dhënave për të punësuarit të cilat i mban shkolla fillore mbahen deri në ndërprerje të marrëdhënies së punës së punonjësit në shkollën fillore.

Puna me të dhëna personale

Neni 105

Mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personat që janë të autorizuar t'i përdorin të dhënave të përfshira në përmbledhjet individuale të të dhënave personale, kriteret sipas të cilave përcaktohet niveli i qasjes së personave të cilët janë të autorizuar t'i përpunojnë të dhënave personale, masat

teknike dhe organizative për sigurim të fshehtësisë dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale, mënyrën e shkatërrimit pas kalimit të afatit për ruajtjen e të dhënave personale dhe masa tjera i përcakton ministri.

IX. ORGANE PËR MENAXHIM, UDHËHEQJE DHE ORGANE PROFESIONALE TË SHKOLLËS FILLORE

Organi për menaxhim të shkollës fillore

Neni 106

(1) Organ i menaxhimit të shkollës fillore është këshilli shkollor.

(2) Këshilli shkollor i shkollës fillore përbëhet nga shtatë anëtarë dhe atë: tre përfaqësues të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorë të shkollës, tre përfaqësues të prindërve, përkatësisht kujdestarët e nxënësve dhe një përfaqësues i themeluesit.

(3) Në mbledhjet e këshillit shkollor, ftohen dhe në punën e vet marrin pjesë, pa të drejtë votimi edhe dy përfaqësues të nxënësve të zgjedhur nga parlamenti i nxënësve.

(4) Anëtarët e këshillit shkollor nuk guxojnë në mënyrë të ndërsjellë dhe me drejtorin e shkollës të jenë në lidhje familjare me vijë të drejtë në çfarëdo shkalle, përkatësisht vijë anësore deri në shkallë të tretë për çka të gjithë anëtarët nënshkruajnë deklaratë.

(5) Mandati i anëtarëve të këshillit shkollor është tre vite, ndërsa mandati i përfaqësuesve të prindërve është për periudhën e mbarimit të arsimit fillor të fëmijës së tyre, por jo më gjatë se tre vite.

(6) Këshilli shkollor nga radhët e anëtarëve të vet – përfaqësues të prindërve, përkatësisht kujdestarëve zgjedh kryetar me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, me votim të fshehtë.

(7) Vendimet e këshillit shkollor miratohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(8) Drejtori i shkollës nuk merr pjesë në punën e këshillit shkollor, por për punë të cilat janë të rëndësishme për përmirësimin e procesit edukativo arsimor në shkollë mund të jetë i ftuar nga kryetari i këshillit shkollor, përkatësisht nga 2/3 se anëtarëve të këshillit shkollor.

Zgjedhja e Këshillit Shkollor

Neni 107

(1) Përfaqësuesit nga mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe edukatorët në këshillin shkollor i zgjedh këshilli i mësimdhënësve me votim të fshehtë.

(2) Përfaqësuesit e prindërve përkatësisht kujdestarët i zgjedh Këshilli i Prindërve me votim të fshehtë.

(3) Përfaqësuesit e bashkësisë shkollore zgjedhën me votim të fshehtë nga parlamenti i nxënësve, që bëhet në fillim të çdo viti shkollor.

(4) Procedura për zgjedhje të përfaqësuesve të punonjësve në shkollën fillore, prindërit përkatësisht kujdestarët në këshillin shkollor të shkollës dhe të përfaqësuesve të bashkësisë shkollore përcaktohet me statutin e shkollës.

Kompetenca e këshillit shkollor

Neni 108

- (1) Këshilli shkollor i shkollës fillore:
- miraton statut të shkollës fillore,
 - propozon program vjetor për punë dhe raport për punë të shkollës fillore në këshillin e komunës, ndërsa shkolla fillore shtetërore në Ministri,
 - miraton program për zhvillim të shkollës,
 - propozon plan financiar të themeluesi,
 - propozon llogari përfundimtare të themeluesi,
 - shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit në së paku tre gazeta ditore që shtypen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të cilat njëra prej gazetave që shtypet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare ndryshe prej gjuhës maqedonase,
 - bën intervistë me kandidatët për drejtor,
 - i propozon kryetarit të komunës përkatësisht ministrit një kandidat prej kandidatëve të paraqitur në konkursin e shpallur publik për zgjedhje të drejtorit,
 - jep propozim të drejtorit për zgjedhje të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë,
 - vendos për kundërshtimet dhe ankesat e të punësuarve në shkollën fillore,
 - vendos për ankesat e nxënësve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve të nxënësve dhe
 - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me statutin e shkollës fillore.
- (2) Këshilli Shkollor i shkollës fillore për ankesat e parashtruara duhet të vendosë në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të ankesës.
- (3) Nëse parashtrues i ankesës është anëtar i Këshillit Shkollor, i njëjti përjashtohet nga procesi i vendimmarrjes për ankesën.

Organi i menaxhimit të shkollës fillore

Neni 109

- (1) Organ i menaxhimit në shkollën fillore është drejtori.
- (2) Drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë në punë dhe për punën materialo-financiare të shkollës.
- (3) Drejtor i shkollës fillore mund të zgjedhet personi i cili ka së paku arsim të lartë dhe i cili i plotëson kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe ka së paku pesë vite përvojë pune në punën edukativo-arsimore, provim të kaluar për drejtor të shkollës fillore dhe në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të ketë certifikatë përkatëse, jo më të vjetër se pesë vite, për njohje të gjuhës angleze TOEFEL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) – të kaluar, ose APTIS – së paku nivelin B2. Përparësi kanë kandidatët me titull mentor dhe këshilltar.
- (4) Nëse nuk ka kandidat të paraqitur me provim të kaluar për drejtor, drejtor mund të zgjedhet edhe personi i cili nuk ka dhënë provim për drejtor,

por është i obliguar atë ta japë në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes për drejtor.

(5) Nëse drejtori i zgjedhur nuk e jep provimin për drejtor në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, i pushon mandati i drejtorit.

(6) Mandati i drejtorit zgjat katër vite.

(7) Mësimdhënësit ose bashkëpunëtorit profesional i cili është i zgjedhur drejtor i shkollës fillore i pushon marrëdhënia e punës gjatë kryerjes së funksionit drejtor i shkollës fillore dhe ka të drejtë në afat prej 15 ditëve pas ndërprerjes së funksionit të cilin e ka kryer, të kthehet në punë në shkollën, përkatësisht institucionin ku ka punuar të jetë i zgjedhur për drejtor, për kryerjen e punëve që i përshtaten llojit dhe shkallës së përgatitjes profesionale.

(8) Nëse për mësimdhënësit apo bashkëpunëtorin profesional nga paragrafi (7) i këtij neni, nuk ka vend të lirë pune ku ka punuar para se të zgjedhet drejtor, mësimdhënësi ose bashkëpunëtorit profesional dhe themelon marrëdhënie pune në kohë të papërcaktuar pune në vendin përkatës të punës për kryerje të punëve të cilat përputhen me llojin e përgatitjes profesionale, në shkollë tjetër të rajonit të komunës, përkatësisht komunat në Qytetin e Shkupit.

Kompetencat profesionale të drejtorit

Neni 110

(1) Drejtori i shkollës fillore duhet të posedojë kompetenca profesionale për drejtor të shkollës.

(2) Kompetencat profesionale kanë të bëjnë me dituritë, shkathtësitë dhe vlerat profesionale që janë të domosdoshme për menaxhim cilësor të shkollës.

(3) Drejtori i fiton kompetencat profesionale gjatë trajnimit për marrje të vërtetimit për provim të kaluar për drejtor, në pajtim me Ligjin për Qendër Shtetërore të Provimeve.

(4) Provimi për marrje të vërtetimit për drejtor jepet në Qendër Shtetërore të Provimeve në pajtim me Ligjin për trajnim dhe provim për drejtor në shkollë fillore, shkollë të mesme, konvikt për nxënës dhe universitet të hapur qytetar për mësim të përhjetshëm.

Neni 111

(1) Kompetencat profesionale përfshijnë dituri, shkathtësi dhe vlera profesionale, në këto fusha:

1. Lidërsip;
2. Menaxhim me resurse njerëzore;
3. Menaxhim pedagogjik të shkollës;
4. Punë financiare dhe
5. Punë ligjore dhe administrative të shkollës.

(2) Kompetencat profesionale në fushat nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Neni 112

Drejtorët gjatë punës së vet janë të obliguar vazhdimisht të përsosin në mënyrë profesionale në pajtim me Ligjin për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollë të mesme, konvikt të nxënësve dhe universitet të hapur qytetar për mësim të përjetshëm.

Kompetenca e drejtorit

Neni 113

Drejtori i kryen këto punë:

- e përfaqëson dhe prezanton shkollën dhe është përgjegjës për punë ligjore,
- e organizon, planifikon dhe udhëheq punën e shkollës fillore,
- e ndjek dhe avancoi punën edukativo-arsimore në shkollë,
- përgatit Program zhvillimor për zhvillim të shkollës,
- përgatit propozim të programit vjetor për punë dhe raport të shkollës,
- është përgjegjës për realizim të programit vjetor për punë,
- është përgjegjës për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të nxënësve,
- është kompetent për paraqitjen e çfarëdo lloji të dhunës, keqpërdorimit dhe anashkalimit të kryer ndaj nxënësit, të institucionet kompetente të përcaktuara me ligj,
- bën zgjedhje të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit tjetër administrativo-technik në pajtim me ligj dhe aktet e shkollës,
- bën sistematizim të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit tjetër administrativo-technik,
- vendos për ndërprerje të marrëdhënies së punës së mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve dhe stafit tjetër administrativo-technik në pajtim me ligj dhe marrëveshje kolektive,
- bën kontroll mbi mënyrën e mbajtjes së dosjeve profesionale të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë,
- stimulon, ndjek dhe organizon aftësim dhe përsosje profesionale të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë,
- organizon mentorim për mësimdhënësit-praktikant, bashkëpunëtorët profesionalë-praktikantë, edukatorët-praktikantë, merr pjesë në orë mësimi në pajtim me planin për ndjekje të orëve nga programi vjetor për punë të shkollës, për çka përpilon rekomandime dhe vërejtje nga ndjekja e realizuar të cilat parashtrihen me dosjen profesionale të mësimdhënësit dhe e ndjek punën e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe edukatorëve dhe i këshillon,
- e ndjek punën e pedagogut shkollor, psikologut dhe punonjësve tjerë profesionalë,
- kujdeset për bashkëpunimin me prindërit përkatësisht kujdestarët,
- i njofton prindërit përkatësisht kujdestarët për punën e shkollës dhe për ndryshime të të drejtave dhe obligimeve të nxënësve,
- vendos për masat edukative,
- e organizon dhe ndjek punën e ekipit inkluziv shkollor dhe të ekipeve tjera në shkollë,
- e ndjek punën e organeve profesionale në shkollën,
- e stimulon dhe ndjek punën e komunitetit të nxënësve,
- siguron zbatimin e vendimeve të këshillit shkollor,

- e miraton sistematizimin e vendeve të punës në shkollë,
- vendos për nënshkrim të marrëveshjeve për marrëdhëniet e punës,
- e formon ekipin inkluziv shkollor,
- inicion procedurë për përgjegjësi disiplinore të punonjësve në shkollë,
- kujdeset për bashkëpunimin e shkollës me institucionin shëndetësor në komunë dhe

- kryen punë tjera në pajtim me ligj dhe statutin e shkollës.

(2) Përveç punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, drejtori i shkollës fillore me qendrën për resurse i kryen edhe punët në vijim:

- bën zgjedhjen e asistentëve arsimorë dhe personalë të cilët u japin përkrahje shkollave fillore në punën me nxënës me pengesa,

- bën sistematizimin e asistentëve arsimorë dhe personalë të cilët u japin përkrahje shkollave fillore në punën me nxënës me pengesa dhe

- stimulon, ndjek dhe organizon aftësim dhe përsosje profesionale të asistentëve arsimorë dhe profesionalë të cilët u japin përkrahje shkollave fillore në punën me nxënës me pengesa.

Ndihmësdrejtori

Neni 114

(1) Në shkollën fillore në të cilën ka mbi 36 paralele ose nëse puna edukativo-arsimore realizohet në më shumë se tre objekte mund të emërohet ndihmësdrejtor për kryerje të punëve udhëheqëse dhe pedagogjike.

(2) Për ndihmës të drejtorit mund të emërohet person i cili i plotëson kushtet për mësimdhënës, përkatësisht bashkëpunëtor profesional të shkollës fillore dhe ka së paku tre vite përvojë pune në fushën e arsimit dhe është nga radhët e të punësuarve në shkollë.

(3) Ndihmësdrejtori emërohet dhe shkarkohet nga drejtori.

(4) Ndihmësdrejtori i kryen punët për të cilat me shkrim e ka autorizuar drejtori dhe e zëvendëson në mungesë të tij.

(5) Nëse në shkollë nuk ka ndihmës të drejtorit, drejtori për kryerjen e detyrave të ndara nga kompetenca e tij dhe për zëvendësim në kohë të mungesës, mund të autorizojë mësimdhënës apo bashkëpunëtor profesional nga shkolla fillore që do ta zëvendësojë.

Procedura për zgjedhje të drejtorit

Neni 115

(1) Drejtorin në shkollë fillore komunale e zgjedh dhe shkarkon kryetari i komunës, me propozim të këshillit shkollor të shkollës fillore.

(2) Drejtorin në shkollë fillore shtetërore e zgjedh dhe shkarkon ministri, me propozim të këshillit shkollor të shkollës fillore.

(3) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri, tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit ekzistues miraton vendim që këshilli shkollor i shkollës të publikojë konkurs publik për zgjedhje të drejtorit.

(4) Nëse kryetari i komunës, përkatësisht ministri, nuk vepron në afatin e përcaktuar në nenin (3) të këtij neni, këshilli shkollor publikon konkurs publik për zgjedhje të drejtorit.

(5) Në konkursin publik të publikuar në shpalljet publike përcaktohen kushtet të cilat duhet t'i plotësojë kandidati për drejtor, dokumentacioni i

nevojshëm, kohëzgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të bëhet zgjedhja.

(6) Kandidatët e paraqitur i parashtrojnë dokumentet e nevojshme në këshillin shkollor të shkollës. Kandidatët me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë program për punë të shkollës për periudhë prej katër vitesh.

(7) Dokumentet e pranuar i shqyrton komisioni i formuar nga tre anëtarë, i zgjedhur nga radhët e anëtarëve të këshillit shkollor, kompetenca e të cilit përcaktohet me statutin e shkollës.

(8) Komisioni nga paragrafi (7) i këtij neni, është i obliguar në afat prej pesë ditëve pas përfundimit të konkursit publik t'i shqyrtojë dokumentet e pranuar.

(9) Kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e parapara në konkursin publik u kthehen dokumentet me arsyetim në afat prej tri ditëve nga dita e shqyrtimit të tyre.

(10) Këshilli shkollor mund të kërkojë dokumente shtesë prej kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me dispozitat në statutin e shkollës.

(11) Këshilli shkollor dhe përfaqësuesi nga Byroja zbatojnë intervistë me kandidatët që i plotësojnë kushtet.

(12) Këshilli shkollor i shkollës fillore komunale, në afat prej shtatë ditëve nga biseda me kandidatët, kryetarin të komunës ia propozon kandidatin që ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit shkollor.

(13) Këshilli shkollor i shkollës fillore shtetërore, në afat prej shtatë ditëve nga biseda me kandidatët, ministrit ia propozon kandidatin që ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit shkollor.

(14) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të propozimit e emëron kandidatin e propozuar për drejtor të shkollës fillore.

(15) Nëse kryetari i komunës në afatin e përcaktuar në paragrafin (14) të këtij neni, nuk e emëron drejtorin, emërimin e bën ministri.

(16) Kandidatët të cilët nuk janë të emëruar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, kanë të drejtë për ankesë në lidhje me zbatimin e procedurës për zgjedhje të drejtorit te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

(17) Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi (16) i këtij neni, kandidati mund të ngrit kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Baza për ndërprerje të mandatit të drejtorit të shkollës fillore

Neni 116

(1) Drejtorit të shkollës fillore i pushon mandati, nëse:

- atë e kërkon vet,
- përgjithmonë e humb aftësinë për kryerje të detyrës drejtor dhe
- i plotëson kushtet për pension me moshë.

(2) Drejtori i shkollës fillore shkarkohet para skadimit të mandatit, nëse:

- bën shkelje të dispozitave të ligjeve ose dispozitave dhe akteve tjera, të përcaktuara nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit ose organe tjera,

- i është shqiptuar ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj,
- nuk e realizon programin për punë dhe nuk realizohen planet dhe programet për punën edukativo-arsimore,
- me fajin e tij u është shkaktuar dëm nxënësve, prindërve të tyre përkatësisht kujdestarëve ose shkollës,
- ekziston dëshmi për presion politik nga drejtori ndaj punonjësve dhe nxënësve,
- lejon organizim të veprimtarive dhe aktiviteteve që janë në kundërshtim me planin dhe programet mësimore dhe
- lejon pagesë të mjeteve të cilat nuk janë të përcaktuara në planin vjetor financiar të shkollës.

Procedura për shkarkim të drejtorit

Neni 117

(1) Nëse ekzistojnë informata të caktuara për veprim të drejtorit në pajtim me dispozitat nga neni 116 paragrafi (2) i këtij ligji, këshilli shkollor konvokon mbledhje në të cilën miratohet konkluzion në formë të shkruar që dërgohet te drejtori.

(2) Drejtori ka të drejtë në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimi të konkluzionit nga paragrafi (1) i këtij neni, me shkrim të prononcohet për konstatimet në konkluzion.

(3) Nëse këshilli shkollor nuk e pranon prononcimin e drejtorit, konvokon mbledhje në afat prej tre ditëve dhe në prezencë të përfaqësuesit të Inspektoratit Shtetëror për Arsim bën intervistë të drejtorit. Përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror për Arsim jep mendim për arsyen e shkarkimit të drejtorit.

(4) Nëse këshilli shkollor vlerëson se është e domosdoshme, në afat prej shtatë ditëve parashtron propozim për shkarkim të drejtorit të shkollës fillore të komunës të kryetari, përkatësisht për drejtorin e shkollës fillore shtetërore të ministri.

(5) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri është i obliguar në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimi të propozimit nga këshilli shkollor ta shkarkojë drejtorin.

(6) Drejtori i shkarkuar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të vendimit të kryetarit të komunës, përkatësisht ministrit ka të drejtë për ankesë në lidhje me zbatimin e procedurës për shkarkim të Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni, kandidati mund të ngrit kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit

Neni 118

(1) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri në afat prej tri ditëve nga dita e shkarkimit të drejtorit, emëron ushtrues detyre për drejtor nga radhët e të punësuarve në shkollë i cili i plotëson kushtet për drejtor.

(2) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri në afat prej pesë ditëve nga dita e emërimit të ushtruesit të detyrës për drejtor, miraton vendim që këshilli shkollor të shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit.

(3) Ushtrues detyre për drejtor emërohet edhe në raste të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të drejtorit.

(4) Ushtruesi i detyrës drejtor i kryen punët deri në emërim të drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

(5) I njëjti person nuk mund të riemërohet për ushtrues të detyrës drejtor i shkollës fillore.

Propozim masa gjatë shkeljeve më të rënda në punën e drejtorit

Neni 119

(1) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, pas konstatimit të shkeljeve të rënda në punën nga neni 116 paragrafi (2) i këtij ligji, te drejtori i shkollës fillore parashtron raport me propozim-masa, sipas të cilave drejtori duhet të veprojë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së raportit.

(2) Nëse drejtori i shkollës nuk vepron në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, Inspektori Shtetëror për Arsim dërgon aktvendim në këshillin shkollor për zbatim të propozim-masave. Afati për zbatimin e aktvendimit është 15 ditë nga dita e pranimin të tij.

(3) Nëse këshilli shkollor nuk vepron sipas aktvendimit për zbatim të masave të propozuara, Inspektori Shtetëror për Arsim e dërgon aktvendimin te kryetari i komunës dhe themeluesi i shkollës fillore, ndërsa për shkollën fillore shtetërore te ministri dhe themeluesi i shkollës fillore.

(4) Kryetari i komunës, përkatësisht ministri në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të aktvendimit për zbatim të masave të propozuara është i obliguar ta shkarkojë drejtorin e shkollës, ndërsa themeluesi këshillin shkollor.

(5) Nëse kryetari i komunës nuk e shkarkon drejtorin, ndërsa themeluesi këshillin shkollor në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, ministri me të drejtën për mbikëqyrje i shkarkon drejtorin dhe anëtarët e këshillit shkollor të shkollës fillore.

(6) Ministri menjëherë, me të drejtën për mbikëqyrje emëron ushtrues detyre nga radhët e të punësuarve në shkollë, i cili i kryen punët më së shumti gjashtë muaj dhe emëron anëtarë të këshillit shtetëror me mandat prej më së shumti një vit.

Udhëheqësi i shkollës rajonale

Neni 120

Shkollën fillore rajonale e drejton udhëheqës i shkollës rajonale, të cilin e emëron dhe shkarkon drejtori nga radhët e mësimdhënësve të shkollës fillore rajonale.

Organet profesionale të shkollës fillore

Neni 121

Organe profesionale të shkollës fillore janë këshilli i mësimdhënësve të shkollës fillore, këshilli i mësimdhënësve klasorë, këshilli i mësimdhënësve lëndorë dhe aktivët profesionalë të mësimdhënësve.

Kompetenca e Këshillit të Mësimdhënësve

Neni 122

(1) Këshillin e Mësimdhënësve të shkollës fillore e përbëjnë mësimdhënësit klasorë dhe lëndorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës. Këshillin e mësimdhënësve e konvokon dhe me atë kryeson drejtori.

(2) Këshilli i Mësimdhënësve të shkollës fillore:

- jep mendime për propozimin e Programit për zhvillim dhe të programit vjetor për punë dhe e ndjek zbatimin e tij,
- propozon anëtarë për ekip inkluziv shkollor dhe për ekipe tjera në shkollë,
- e shqyrton dhe e përcakton suksesin e nxënësve dhe punën e organeve tjera profesionale,
- u siguron nxënësve përparim më të shpejtë në shkollën fillore,
- e shqyrton realizimin e planit dhe programeve mësimore dhe ndërmerr masa për realizimin e tyre,
- jep mendim për shpërndarje të orëve ndërmjet mësimdhënësve,
- miraton vendime për ankesa të nxënësve për nota të përcaktuara,
- e shqyrton raportin nga realizimi i programit vjetor për punë, nga vet-evaluimi, nga evaluimi i kryer integral dhe propozon masa përkatëse,
- debaton dhe vendos për çështje profesionale në lidhje me punën edukativo-arsimore,
- jep mendim për planin vjetor financiar të shkollës,
- zgjedh përfaqësues në këshillin shkollor,
- jep mendim për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e arritjeve në mësimdhënien dhe mësimnxënien,
- e shqyrton raportin vjetor për punë të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe propozon masa përkatëse,
- merr pjesë në vlerësimin e plotësimit të standardeve për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për avancim në titujt mentor dhe këshilltar,
- vendos për masat edukative dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Këshilli i Mësimdhënësve Klasorë

Neni 123

(1) Këshillin e Mësimdhënësve Klasorë e përbëjnë mësimdhënësit klasorë, mësimdhënësit lëndorë të cilët përfshihen në realizimin e mësimin nga klasa e parë deri në të pestë dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës.

(2) Këshilli i mësimdhënësve klasorë i shqyrton: programin vjetor për punë dhe planifikimin e mësimin, çështjet në lidhje me punën edukativo-arsimore në klasa, merr pjesë në përgatitje të programit për punë me nxënës të talentuar dhe me dhunti, përkatësisht për nxënësit të cilët më vështirë

përparojnë, propozon dhe vendos për masat edukative dhe kryen punë tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Këshilli i Mësimdhënësve Lëndorë

Neni 124

(1) Këshillin e Mësimdhënësve Lëndorë e përbëjnë mësimdhënësit lëndorë të cilët e realizojnë mësimin nga klasa e gjashtë deri në klasë të nëntë dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës.

(2) Këshilli i Mësimdhënësve Lëndorë i shqyrton programin vjetor për punë dhe planifikimin e mëimit, problemet edukativo-arsimore në klasa, merr pjesë në përgatitje të programit për punë me nxënës të talentuar dhe me dhunti, përkatësisht me ata të cilët më vështirë përparojnë, vendos për masat edukative dhe kryen punë tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Aktivët Profesionalë të Mësimdhënësve

Neni 125

(1) Aktivët Profesionalë të Mësimdhënësve i përbëjnë mësimdhënësit të cilët ligjërojnë lëndën apo lëmin e njëjtë.

(2) Në shkollën fillore mund të formohen edhe aktivë profesionalë të mësimdhënësve për përkrahje dhe bashkëpunim të ndërsjellë, ndarje të diturive dhe praktikave pedagogjike dhe ndërmarrje të iniciativave për përmirësim të cilësisë së punës edukativo-arsimore të shkollës.

(3) Aktivët profesionalë të shkollës i harmonizojnë kriteret për planifikim të mëimit dhe për vlerësim të arritjeve të nxënësve, japin propozime të këshillave të mësimdhënësve të shkollës për përmirësim të punës edukativo-arsimore, vendosin për përdorim të librave në shkollën fillore, debatojnë për vërejtjet e prindërve përkatësisht kujdestarëve, nxënësve, këmbëjnë përvoja profesionale me qëllim të përsosjes profesionale dhe kryejnë punë tjera profesionale të përcaktuara me programin vjetor për punë të shkollës.

Detyra të udhëheqësit të klasës, përkatësisht të paraleles

Neni 126

Udhëheqësi klasor, përkatësisht i paraleles e realizon programin për orën e bashkësisë së klasës, i analizon rezultatet edukative dhe mësimore të klasës, kujdeset për zgjidhje të problemeve edukative dhe arsimore të nxënësve të caktuar, kujdeset për progresin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, përpilon dhe/ose merr pjesë në përgatitjen e planit individual për nxënësit me pengesa, bashkëpunon me prindërit përkatësisht kujdestarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë të shkollës, propozon dhe vendos për masat edukative, ndihmon në orientimin profesional të nxënësve dhe kryen punë tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

Këshilli i Prindërve

Neni 127

(1) Për realizim të organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore nga prindërit, përkatësisht kujdestarët e nxënësve formohet këshill prindëror i shkollës.

(2) Në Këshillin e Prindërve ka nga një përfaqësues nga secila paralele të cilin e zgjedhin prindërit përkatësisht kujdestarët, në takimin prindëror të paraleles.

(3) Konvokimin e parë të këshillit të prindërve e bën drejtori i shkollës.

(4) Këshilli i Prindërve:

- jep mendim për propozimin e programit për zhvillim të shkollës fillore dhe për programin vjetor për punë,

- diskuton për raportin për punën e shkollës,

- jep mendim dhe propozon masa për përmirësim të mësimi dhe aktiviteteve jashtë – mësimore,

- shqyrton ankesa të prindërve përkatësisht kujdestarëve në lidhje me punën edukativo-arsimore,

- merr pjesë në vet-evaluimin e punës dhe arritjeve të shkollës,

- inicion dhe zbaton aktivitete për përmirësim të cilësisë së shkollës,

- merr pjesë në vlerësimin e plotësimit të standardeve për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për avancim në titujt mentor dhe këshilltar,

- zgjedh përfaqësues në këshillin shkollor të shkollës fillore dhe

- kryen edhe punë tjera të përcaktuara në statutin e shkollës.

X. SIGURIMI DHE VLERËSIMI I CILËSISË SË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

Lloje të vlerësimit të cilësisë së punës së shkollës

Neni 128

Cilësia e punës së shkollës matet nëpërmjet vet-evaluimit, evaluimit integral dhe matjeve të jashtme të arritjeve të nxënësve, si dhe me vlerësim të punës së mësimdhënësve dhe drejtorëve, që bëhen në pajtim me ligj.

Vetevaluimi

Neni 129

(1) Në çdo dy vite shkolla bën vet-evaluim për punën dhe arritjet e saj.

(2) Vetevaluimin e zbaton komision shkollor i formuar nga pesë anëtarë nga radhët e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, edukatorëve dhe prindërve përkatësisht kujdestarëve të cilin me propozim të drejtorit e formon këshilli shkollor.

(3) Fushat për vet-evaluim janë të harmonizuara me fushat nga evaluimi integral, në pajtim me dispozitat nga fusha e inspeksionit arsimor.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, përpilon raport për vetevaluimin e zbatuar me propozim të masave për përmirësim të cilësisë së punës edukativo-arsimore të cilën e parashtron te këshilli shkollor, drejtori i shkollës dhe themeluesi.

(5) Këshilli shkollor dhe drejtori duhet t'i kenë parasysh rekomandimet nga vet-evaluimi i zbatuar gjatë përpunimit të programit vjetor për punë të shkollës dhe program zhvillimor.

(6) Byroja nëpërmjet vizitave këshillëdhënëse jep udhëzime, këshilla profesionale dhe përkrahje në procesin e zbatimit të vet-evaluimit.

Publikimi i rezultateve nga vetevaluimi

Neni 130

(1) Rezultatet nga vetevaluimi i shkollave fillore publikohen në internet faqen e shkollës dhe të komunës.

(2) Raportin me rezultatet nga vet-evaluimi shkolla në formë elektronike e dërgon te Qendra Shtetërore e Provimeve , në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të vet-evaluimit.

(3) Qendra Shtetërore e Provimeve në ueb portal të veçantë i publikon të gjitha raportet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Qendra Shtetërore e Provimeve përpunon raport nacional me të dhëna dhe konstatime prej rezultateve nga testimet ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë Republika e Maqedonisë së Veriut, raport në të cilin jep edhe rekomandime për masa për përmirësimin e rezultateve dhe të njëjtin e publikon publikisht në internet faqen e saj dhe e dërgon në Ministri.

Ndjekja dhe vlerësimi i punës së mësimdhënësve

Neni 131

(1) Ndjekja dhe vlerësimi i punës së mësimdhënësve bëhet në shkollë nga drejtorit, si dhe nga Byroja.

(2) Ndjekja dhe vlerësimi ka të bëjë me cilësinë e punës dhe arritjen e kompetencave dhe standardeve të mësimdhënësve. Në bazë të informatave nga ndjekja dhe vlerësimi mësimdhënës merr raport me informatë kthyesë dhe udhëzime për punë të mëtutjeshme, që mbahet në dosjen e mësimdhënësit. Raportet nga ndjekja dhe vlerësimi i mësimdhënësve përdoren për avancim në punën e shkollës dhe për avancim në karrierë të mësimdhënësve.

(3) Ministri e përcakton mënyrën e ndjekjes dhe vlerësimit të punës së mësimdhënësve, me propozim të Byrosë.

Matje të jashtme të arritjeve të nxënësve

Neni 132

(1) Matjet e jashtme të arritjeve të nxënësve i zbaton Qendra Shtetërore e Provimeve.

(2) Matjet e jashtme të arritjeve të nxënësve i përfshijnë testimet shtetërore dhe ndërkombëtare për lëndë dhe lëmi të ndara mësimi.

Testimi shtetëror

Neni 133

(1) Realizimi i standardeve të arritjeve gjatë arsimit fillor kontrollohet me testim shtetëror që zbatohet nga Qendra Shtetërore e Provimeve.

(2) Nxënësi është i obliguar të marrë pjesë në testimin shtetëror.

(3) Drejtori është i obliguar t'i sigurojë kushtet për testim shtetëror dhe rregullshmërinë e testimit.

(4) Rezultatet nga testimi shtetëror nuk ndikojnë në notat, përkatësisht në suksesin e përgjithshëm të nxënësve.

(5) Periudhat, ciklet dhe fushat për testimet shtetërore, si dhe ekzemplarin reprezentativ të nxënësve që do të jenë të përfshirë, rregullohen me Konceptin për testim shtetëror, të cilin e miraton ministri, me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(6) Raporte nga testimet shtetërore publikohen në internet faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(7) Me leje nga ministri mund të realizohen edhe teste tjera të nxënësve, në drejtim të avancimit të procesit edukativo-arsimor.

Testimi ndërkombëtar

Neni 134

(1) Shkollat marrin pjesë në teste ndërkombëtare të zbatuara nga Qendra Shtetërore e Provimeve, me pajtim paraprak nga ministri.

(2) Raportet nga testimet ndërkombëtare publikohen në internet faqen e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(3) Qendra Shtetërore e Provimeve përgatit Raport nacional me njoftime dhe konst nga rezultatet ndërkombëtare të testimit në të cilat ka marrë pjesë Republika e Maqedonisë së Veriut, në të cilin raport jep edhe rekomandime dhe masa për përmirësimin e rezultateve.

(4) Raport nacional nga paragrafi (3) i këtij neni, dorëzohet në Ministri dhe publikohet në faqen e internetit të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Evalvimi integral

Neni 135

(1) Në çdo tre vite në shkollë bëhet evalvim integral për punë të shkollës nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në pajtim me ligjin.

(2) Evalvimi integral në pjesën e ndjekjes së cilësisë së punës së shkollës i përfshin fushat në pajtim me fushën e inspeksionit arsimor.

(3) Raportin nga evalvimi i zbatuar integral me masa të propozuara, Inspektorati Shtetëror i Arsimit e dërgon tek shkolla dhe themeluesi.

(4) Raportin për evalvimin e zbatuar integral, Inspektorati Shtetëror i Arsimit në version elektronik e dërgon te Qendra Shtetërore e Provimeve, në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të evalvimit integral.

(5) Qendra Shtetërore e Provimeve në internet faqen e veti publikon të gjitha raportet nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Këshilli shkollor dhe drejtori duhet t'i kenë parasysh rekomandimet nga evalvimi integral i zbatuar gjatë përpunimit të programit vjetor për punë të shkollës dhe program zhvillimor.

Analiza dhe politika për arsim

Neni 136

(1) Raportet nga vetevalvimet e zbatuara, evalvimet integrale, raportet nga arritjet e nxënësve të shkollës në matjet shtetërore dhe ndërkombëtare janë publike dhe të njëjtat publikohen në faqen e internetit të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(2) Ministria në çdo katër vite përpilon raport vjetor për gjendjen në arsimin fillor me rekomandime për përmirësim të cilësisë, që parashtrohet në Qeveri dhe publikohet në internet faqen e Ministrisë.

(3) Sipas nevojës, Ministria përpilon raporte për segmente të ndara të arsimit fillor, të cilat dërgohen në Qeveri dhe publikohen në internet faqen e Ministrisë.

XI. VLERËSIMI I ARRITJEVE DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE

Testimi intern i suksesit të nxënësve

Neni 137

Ndjekjen dhe testimin e përparimit dhe arritjeve të suksesit të nxënësve e bëjnë mësimdhënësit e shkollës.

Vlerësimi dhe notat e nxënësve

Neni 138

(1) Arritjet e nxënësve në shkollën fillore kontrollohen në mënyrë formative dhe përmblendhëse dhe regjistrohen me nota përshkruese dhe/ose numerike.

(2) Në periudhën e parë, arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët obligative dhe zgjedhore regjistrohen me nota përshkruese.

(3) Nxënësi nga paragrafi (2) i këtij neni, në fund të gjysmëvjetorit të parë pranon njoftim për suksesin me nota përshkruese, ndërsa në fund të vitit shkollor pranon dëftesë me nota përshkruese.

(4) Në periudhën e dytë, arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët obligative dhe zgjedhore regjistrohet me nota përshkruese dhe numerike.

(5) Nxënësi nga paragrafi (4) i këtij neni, në fund të gjysmëvjetorit të parë pranon njoftim për suksesin me nota përshkruese, ndërsa në fund të vitit shkollor pranon dëftesë me nota numerike dhe notë për sukses të përgjithshëm.

(6) Në periudhën e tretë, arritja e nxënësit gjatë vitit mësimor për lëndët obligative dhe zgjedhore regjistrohet me nota numerike.

(7) Nxënësi nga paragrafi (6) i këtij neni, në fund të gjysmëvjetorit të parë pranon njoftim për suksesin me nota numerike, ndërsa në fund të vitit shkollor pranon dëftesë me nota numerike dhe notë për sukses të përgjithshëm.

(8) Suksesi i përgjithshëm i nxënësit përcaktohet në bazë të notave vjetore nga të gjitha lëndët sipas planit mësimor në fund të vitit, ndërsa për nxënësit e dërguar në riprovim pas mbarimit të riprovimeve.

(9) Notat numerike janë: shkëlqyeshëm (5), shumë mirë (4), mirë (3), mjaftueshëm (2) dhe pamjaftueshëm (1). Të gjitha notat janë kalimtare, me përjashtim të notës pamjaftueshëm (1).

(10) Nota më e lartë është shkëlqyeshëm (5).

(11) Vlerësimi i nxënësit bëhet në pajtim me standardet për vlerësim të programeve mësimore.

(12) Vlerësimi i nxënësit me nota numerike bëhet edhe në pajtim me kriteret për vlerësim me numër që i përpilon Byroja.

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara

Neni 139

(1) Në periudhën e parë, arritjet e nxënësit që përcjell mësim sipas IOP vlerësohen me përshkrim.

(2) Në periudhën e dytë dhe të tretë, arritjet e nxënësit të cilët ndjekin mësim sipas IOP mund të vlerësohen me përshkrim dhe me numra.

(3) Nxënësit të cilët ndjekin mësim sipas programit të modifikuar, vlerësohen me përshkrim në të gjitha periudhat e arsimit fillor në pajtim me arritjen individuale të rezultateve të përcaktuara.

(4) Mënyra e vlerësimit të nxënësve me aftësi të kufizuara adaptohet në pajtim me nevojat e tyre: testet me shkrim me alfabetin e Brajtit, format i zmadhuar, në version elektronik, audio format dhe ngjashëm, përdorim të teknologjisë asistuese, kohë më të gjatë për testin, ndihmë gjatë leximit të pyetjeve nga testi, pauza me vëzhgim dhe plan fleksibël mësimor, prani e asistentit arsimor.

(5) Mënyrën e vlerësimit të nxënësve me pengesë e përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

Informimi i prindërve përkatësisht kujdestarëve për suksesin e nxënësit

Neni 140

(1) Mësimdhënësi klasor, përkatësisht udhëheqësi i paraleles është i obliguar në vazhdimësi gjatë vitit shkollor t informojë nxënësin për përparimin e tij dhe arritjet për çdo lëndë të veçantë mësimore.

(2) Mësimdhënësi klasor, përkatësisht udhëheqësi i paraleles është i obliguar ta informojë prindin, përkatësisht kujdestarin për suksesin e nxënësit së paku dy herë në çdo gjysmëvjetor përkatësisht në takim prindëror më së shumti tri ditë pas përfundimit të këshillave klasorë për përcaktim të suksesit dhe sjelljes së nxënësve për tremujorin e parë, gjysmëvjetorin e parë, tremujorin e tretë dhe në fund të vitit mësimor nëpërmjet parashtrimit të fletëve të evidencës.

Përsëritja e vitit klasor

Neni 141

(1) Nxënësi nga klasa e parë me përfundim të klasës së pestë, sipas rregullit, nuk mund ta përsërisë vitin.

(2) Nxënësi i cili nuk ka arritur deri në fund të vitit shkollor të arrijë minimum të rezultateve nga mësimnxënia për të kaluar në klasën tjetër, t'i përvetësojë përmbajtjet deri në fund të vitit shkollor me propozim të mësimdhënësit klasor dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollës, ndërsa në pajtim me prindin, përkatësisht kujdestarin mund të mbetet në klasën e njëjtë, për çfarë vendim sjell Këshilli i Mësimdhënësve të Shkollës.

Provimi përmirësues

Neni 142

(1) Nxënësi i cili në fund të vitit mësimor në klasë të gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë ka notë negative deri në dy lëndë udhëzohet në provim përmirësues.

(2) Për nxënësin e klasës nga e gjashta, e shtata, e teta dhe e nënta që deri në fund të vitit shkollor ka dy nota negative, shkolla fillore është e obliguar që në muajin qershor të organizojë mësim shtesë në lëndët mësimore për të cilat nxënësi ka nota negative në kohëzgjatje të paktën 30% të numrit të orëve të përcaktuara nga programi mësimor.

(3) Nxënësi nga paragrafi (2) i këtij neni, i cili pas mësimit plotësues të mbajtur nuk ka arritur kriteret për vlerësim pozitiv, dërgohet në provim përmirësues.

(4) Provimet përmirësuese nxënësi i kalon në qershor dhe/ose gusht.

(5) Nxënësi nga paragrafi (3) i këtij neni, i cili nuk do ta kalojë provimin përmirësues në një ose dy lëndë, mbetet në të njëjtën klasë.

(6) Nxënësi që në fund të vitit shkollor në klasën e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, ka më shumë se dy nota negative mbetet në të njëjtën klasë.

Notat vjetore

Neni 143

(1) Notat vjetore, kujdestari respektivisht udhëheqësi i klasës prindërve respektivisht kujdestarëve ua shpalos në mbledhje prindërore që mbahet tri ditë pune pas mbajtjes së këshillit të arsimtarëve në të cilin përcaktohen notat vjetore të nxënësve.

(2) Nëse nxënësi ose prindi respektivisht kujdestari nuk janë të kënaqur me vlerësimin vjetor, prindi respektivisht kujdestari ka të drejtë, në afat prej tre ditëve të punës nga dita e kumtimit të suksesit, të paraqesë vërejtje me shkrim në këshillin e shkollës, i cili duhet të jetë i arsyetuar.

(3) Këshilli i arsimtarëve për ankesën vendos ditën e ardhshme pas mbarimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Këshilli i arsimtarëve mund ta pranojë, ta refuzojë kundërshtimin ose të organizojë kontroll të njohurive të studentit.

(5) Për kontroll të sërishëm të njohurive, drejtori, më së voni në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit të kundërshtimit, formon komision për kontroll të sërishëm të njohurive.

(6) Komisioni nga paragrafi (5) i këtij neni përbëhet nga kryetari dhe dy anëtar-pyetës.

(7) Kryetari i komisionit, sipas rregullit, është kujdestari i klasës respektivisht udhëheqësi i klasës në të cilën mëson nxënësi kurse për anëtarë-pyetës emërohen mësimdhënësit në lëndën për të cilën kontrollohet njohuria nga radhët e mësimdhënësit në shkollë ose nga shkollë tjetër fillore.

(8) Kryetar dhe anëtar testues i komisionit nuk mund të jetë mësimdhënësi i cili e ka caktuar notën

(9) Nota e komisionit është përfundimtare.

Provimi klasor

Neni 144

(1) Nxënësi i cili nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës të paktën një të tretën e fondit të orëve mësimore në lëndë të caktuara, ka të drejtë të kalojë provim klasor për lëndët për të cilat ai nuk është vlerësuar.

(2) Për miratimin e dhënies së provimit nga paragrafi (1) i këtij neni, vendos Këshilli i arsimtarëve të shkollës.

Avancimi i shpejtë i nxënësit

Neni 145

(1) Nxënësi i cili ka sukses të përgjithshëm të shkëlqyeshëm dhe veçanërisht dallon me aftësi, njohuri dhe shprehi të punës mund të përparojë më shpejt.

(2) Nxënësi nga klasa e parë deri në klasën e tretë, me propozimin e mësimdhënësit të klasës dhe sipas mendimit të bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollës dhe pëlqimin e prindit, respektivisht kujdestarit mund të avancohet më shpejtë dhe të kalojë në klasën e ardhshme për të cilën vendim merr këshilli i arsimtarëve.

(3) Nxënësi nga klasa e katërt deri në të nëntën, me propozimin e kujdestarit të klasës kurse pas miratimit të këshillit të arsimtarëve dhe pëlqimin e prindit, respektivisht kujdestarit mund të avancohet më shpejtë dhe të kalojë në klasën e ardhshme për të cilën vendim merr këshilli i arsimtarëve.

(4) Nëse nxënësi përparon më shpejt në periudhën e parë kalon pa i dhënë provimet për avancim më të shpejtë kurse avancohet më shpejt në të dytën, respektivisht periudhën e tretë jep provime për avancim më të shpejtë.

(5) Të drejtën nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni nxënësi mund ta shfrytëzojë më së shumti dy herë gjatë arsimit fillor.

(6) Shkolla fillore ka obligim për nxënësin i cili më shpejtë është avancuar të organizojë ndihmë metonimi dhe ndihmë konsultative nga mësimdhënësit në lëndët e përkatëse.

Komisioni testues për provim klasor, provim përmirësues ose provim për avancim më të shpejtë

Neni 146

(1) Provimi klasor, provim përmirësues ose provim për avancim më të shpejtë nxënësi e jep para komisionit testues.

(2) Komisionin nga paragrafi (1) të këtij neni, e formon drejtori i shkollës dhe përbëhet nga kryetar dhe dy anëtarë mësimdhënës njëri prej të cilëve është mësues i lëndës përkatëse.

XII. NJOHJA DHE EKVIVALENCA E DËFTESAVE TË MARRA JASHTË VENDIT

Kërkesa për njohje dhe ekuivalencë

Neni 147

(1) Shtetasi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili ka përfunduar arsimin fillor jashtë shtetit ose ka kryer një klasë të veçantë të arsimit fillor dhe edukim, ka të drejtë të kërkojë njohjen e dëftesës dhe ekuivalencës në pajtim me këtë ligj, nëse me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare në

përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndryshe nuk është përcaktuar.

(2) Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi kanë të drejtë të kërkojnë njohjen dhe ekuivalencën e dëftesës së fituar jashtë vendit.

Nocioni i njohjes dhe ekuivalencës

Neni 148

(1) Me njohjen kryhet njohje e dëftesës të fituar jashtë vendit si tërësi në pikëpamje të të drejtave që i takojnë poseduesit të dëftesës për vazhdimin e arsimit.

(2) Me ekuivalencën kryhet barazim i dëftesës së fituar jashtë vendit me dëftesë përkatëse të marrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Njohjen dhe ekuivalencën e dëftesës së marrë jashtë vendit e kryen Ministria.

Rëndësia e njohjes dhe ekuivalencës

Neni 149

Me njohje dhe ekuivalencë të dëftesës së marrë jashtë vendit barazohet me dëftesë të marrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në tërësi në pikëpamje të të drejtave që i takojnë poseduesit të dëftesës për vazhdimin e arsimit.

Elementet të cilat merren parasysh gjatë ekuivalencës dhe njohjes

Neni 150

(1) Në procedurë për pranimin e ekuivalencës së dëftesës të marrë jashtë vendit, merret parasysh:

- sistemi i arsimit në shtet në të cilin dëftesa është fituar,
- zgjatja e arsimit,
- plani mësimor dhe programe,
- të drejtat që dëftesa i jep poseduesit në vendin ku është fituar dhe
- punë tjera me rëndësi për njohje dhe ekuivalencë.

(2) Nëse në procedurën për njohjen dhe ekuivalencë përcaktohet që plani mësimor dhe programet devijojnë në mënyrë të konsiderueshme nga plani mësimorë dhe programet në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të cilën krahasohet, njohja kushtëzohet nga kalimi i lëndëve.

Dokumentacioni i nevojshëm për njohje

Neni 151

(1) Me kërkesën për njohjen e dëftesës të marrë jashtë vendit kërkuesi paraqet kërkesë me dokumentacionin e nevojshëm, dhe atë:

- dëftesa origjinale ose diplomë dhe një kopje të vërtetuar në noter,
- përkthim në gjuhën maqedonase nga përkthyes i autorizuar gjyqësor të dëftesës ose diplomës (tre ekzemplarë),
- ekzemplar origjinal nga fletëpagesa për mjete të paguara për njohjen e dëftesës ose diplomës së fituar jashtë vendit,

- nëse është shfrytëzues i ndihmës minimale të garantuar vërtetim për shfrytëzimin e kësaj kategorie të ndihmës (lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në emër të bartësit të të drejtës në amvisëri).

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri.

(3) Gjatë njohjes kryhet edhe ekuivalencë e dëftesës, përveç nëse parashtruesi i kërkesës gjatë plotësimit të formularit të kërkesës e zgjedh opsionin procedurat të ndahen, respektivisht kërkon vetëm njohje ose vetëm ekuivalencë.

(4) Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e udhëheq procedurën për njohjen e dëftesës të fituar jashtë vendit është i detyruar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për njohje sipas detyrës zyrtare, të kërkojë dokumentacionin nga paragrafi (1) alineja 4 nga ky nen, për të cilin organi publik kompetent mban evidencë zyrtare.

(5) Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent nga i cili kërkohet dokumentacioni nga paragrafi (1), alineja 4 të këtij neni, është i detyruar të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

(6) Nëse kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk përmban dokumentacion të plotë, Komisioni në afat prej 15 ditëve nga marrja e kërkesës e njofton personin me shkrim për dokumentacionin i cili mungon.

Regjistrimi me kusht në shkollë gjatë njohjes së papërfunduar

Neni 152

(1) Personi i cili ka paraqitur kërkesë për njohjen dhe ekuivalencën e dëftesës të fituar jashtë shtetit me kusht mund ta ndjekë klasën e ardhshme nëse procedura nuk përfundon me kalimin e afatit për regjistrimin e nxënësve në shkollë.

(2) Nxënësi dëftesa e të cilit në bazë të njohjes , respektivisht ekuivalencës së kryer jep të drejtë të regjistrohet në një vit më të ulët se viti në të cilin është i regjistruar me kusht, bartet në vitin e duhur dhe me atë anulohet regjistrimi i kushtëzuar.

Lloje të aktvendimeve për njohje dhe ekuivalencë

Neni 153

(1) Në varshmëri të kërkesës, Ministria dorëzon:

- aktvendim për njohje dhe ekuivalencë,
- aktvendim për njohje dhe
- aktvendim për ekuivalencë.

(2) Aktvendim për njohje dhe ekuivalencë, aktvendim për njohjen dhe aktvendim të ekuivalencës së dëftesës të marrë jashtë vendit miraton Ministria, në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për njohje respektivisht ekuivalencë, me propozim të komisionit për njohje dhe ekuivalencë .

(3) Komisionin nga paragrafi (2) i këtij neni e formon ministri dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, me arsim të lartë të kryer dhe së paku shtatë vjet përvojë pune në veprimtarinë edukative arsimore ose në organ të administratës shtetërore kompetent për punët e arsimit .

(4) Më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni janë nga veprimtaria edukative arsimore.

(5) Kundër aktvendimit për refuzim të njohjes respektivisht ekuivalencës mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit.

Kompensimi i shpenzimeve për njohje

Neni 154

(1) Kompensimi i shpenzimeve në procedurë për njohje përcaktohet në bazë të shpenzimeve të bëra reale.

(2) Nga shpenzimet e procedurës për njohje lirohen përfituesit e ndihmës minimale të garantuar.

(3) Shuma e kompensimit për shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e shpërndarjes së kompensimit i përcakton ministri.

Evidenca e njohjes dhe ekuivalencës

Neni 155

Ministria e mban dokumentacionin e njohjes, përkatësisht ekuivalencës së kryer dhe për këtë mban evidencë.

Formularët për njohje

Neni 156

Formën dhe përmbajtjen e formularëve për njohje përkatësisht ekuivalencë, dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës i përcakton ministri.

XIII. FINANCIMI I ARSIMIT FILLOR

Financimi nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 157

(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë në arsimin fillor sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Ligjin për Buxhetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligjin për zbatimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal

(2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni, komunave u shpërndahen përmes bllok-dotacioneve dhe dotacioneve me dedikim në përputhje me Urdhëresën për metodologjinë e përcaktimit të kriterëve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve dhe me Urdhëresën e metodologjisë për shpërndarjen e dotacioneve kapitale dhe dotacioneve me dedikim të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal.

(3) Komuna mjetet nga paragrafi (2) i këtij neni ua shpërndan shkollave fillore të rajonit të vet për sigurimin e realizimit të procesit edukativ-arsimor, në përputhje me standardet dhe normat e përcaktuara.

(4) Mjetet të cilat komunat i marrin në bllok dotacione dhe nga dotacionet me dedikim për fëmijët me pengesa, shpërndahen në shkolla në pajtim me numrin e nxënësve me pengesa në shkolla konkrete dhe në shkollat i harxhojnë me dedikim për nevojat e këtyre nxënësve.

(5) Me Urdhëresat nga paragrafi (2) i këtij neni, rregullohet shpërndarja e mjeteve nga bllok dotacioni dhe nga dotacioni me dedikim e cila bëhet në bazë të formulës dhe në përputhje me fazat e decentralizimit fiskal të përcaktuara në Ligjin për financimin e njësive të vetadministrimit lokal.

(6) Formula nga paragrafi (5) i këtij neni, për shpërndarjen e mjeteve kryesisht realizohet në bazë të numrit të nxënësve në shkollat fillore të rajonit të vet. Në realizimin e formulës ndikim mund të kenë edhe treguesit e tjerë plotësues

Financimi nga burime tjera

Neni 158

(1) Komuna mund të plotësojë bllok dotacionin e marrë, respektivisht dotacion të dedikuar për arsimim me mjete nga burimet e veta, përveç për rroga të të punësuarve në shkolla.

(2) Mjetet për financimin e veprimtarisë në arsimin fillor mund të sigurohen edhe nga burime të tjera (legate, dhurata, teste etj.), e përdoren me dedikim për zhvillimin e veprimtarisë edukative arsimore.

Publikimi i planit financiar dhe llogarisë përfundimtare e shkollave fillore

Neni 159

Të dhënat nga plani financiar vjetor dhe nga llogaria përfundimtare e shkollave fillore, komuna i shpall në fletoren e vet zyrtare.

Aktet nënligjore për financimin e arsimit fillor

Neni 160

(1) Ministria për mjetet e arsimit të arsimit fillor miraton plan dhe programe financiare dhe përlllogaritje vjetore.

(2) Ministria përcakton masa dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore shtetërore.

(3) Këshilli komunal përcakton masa dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore komunale.

(4) Ministria e kontrollon shfrytëzimin me dedikim të mjeteve që shpërndahen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sigurimi për përgjegjësi nga dëmi i shkaktuar

Neni 161

Shkollat fillore kanë janë të detyruara të kontraktjnë sigurim përkatës për përgjegjësi nga dëmi i shkaktuar, për të cilën gjë mjetet i siguron themeluesi.

XIV. MBIKËQYRJA

Organet që kryejnë mbikëqyrje

Neni 162

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Ministria.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar të komunave, në përputhje me ligjin.

Mbikëqyrja inspektuese

Neni 163

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës konstaton se për herë të parë është bërë parregullsi nga dispozitat kundërvajtëse të këtij ligji, është i detyruar të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose shkollës fillore, ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar komunal i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të njëlllojta për një ose më shumë persona, përkatësisht për një apo më shumë shkolla fillore.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose shkolla fillore për të cilën realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është kryer.

(6) Nëse personi ose shkolla fillore për të cilën realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit ose inspektori i autorizuar i komunës gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese, konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri.

Evalvimi integral i jashtëzakonshëm

Neni 164

(1) Nëse Inspektorati Shtetëror i Arsimit vlerëson se në shkolla është prishur rëndë procesi edukativo arsimor, kryen evaulim të jashtëzakonshëm integral dhe e ngarkon shkollën të mënjsnojë arsyet për shkeljet në afat prej një viti nga dita e pranimit të raportit për vlerësimin integral të kryer.

(2) Kërkesa për evaulim integral të jashtëzakonshëm në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit mund të paraqesin këshilli i komunës, kryetari i komunës ose këshilli i prindërve.

Mbikëqyrja nga Ministria

Neni 165

(1) Kur Ministria do të konsiderojë se statuti ose ndonjë akt tjetër i shkollës fillore nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, ka të drejtë aktin ta ndërpresë nga zbatimi i aktit deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Nëse Ministria gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, konstaton se shkolla fillore ka lëshuar dëftesa në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, miraton aktvendim për shfuqizimin e tyre e cila botohet në mjetet e informimit publik dhe paraqet kallëzim te organi për ndjekje penale.

Kompetencat e Ministrisë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 166

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës, Ministria i kryen punët si vijojnë:

- e ndjek ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, ndërmerr masa dhe aktivitete dhe ngre iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës në përputhje me këtë ligj,

- vlerëson nëse organet e komunës i kryejnë kompetencat në përputhje me këtë ligj,

- u sugjeron organeve të komunës për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe me rregulla të tjera dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e situatës së tillë,

- sugjeron për mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunës me të cilat pamundësohet kryerja e punëve nga fusha e arsimit fillor me rëndësi lokale,

- jep rekomandime për zbatim konsekuent të kompetencave të komunës në përputhje me këtë ligj, me kërkesë të organeve të komunës,

- e ndjek miratimin me kohë të rregullave të komunës të parapara me këtë ligj,

- e ndjek ligjshmërinë e aktvendimeve që i miraton kryetari i komunës në zgjidhjen e të drejtave individuale, obligimeve dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë dhe ndërmerr masa në përputhje me këtë ligj,

- jep mendime dhe ndihmë profesionale në lidhje për propozimet e dispozitave të komunës të parapara me këtë ligj, me kërkesë të organeve të komunës

- e ndjek realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës, në realizimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj, kurse veçanërisht nga aspekti i njoftimit të rregullt, me kohë, të drejtë dhe të plotë të qytetarëve,

- e ndjek realizimin e mbikëqyrjes paraprake mbi rregullat e komunës dhe

- me kohë i njofton organet e komunës për gjendjet e konstatuara gjatë punës së tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Për masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga paragrafi (1) alinetë 6 dhe 7 të këtij neni, Ministria e informon organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal.

Heqja e kompetencave

Neni 167

(1) Nëse edhe krahas sugjerimeve dhe masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës nuk e sigurojnë realizimin e punëve të cilat janë përcaktuar me ligj si kompetencë e saj dhe për realizimin e të cilave kompetente është komuna, me fuqinë e këtij ligji u hiqet kryerja e kompetencës përkatëse

(2) Kryerjen e punëve të hequra e ndërmerr Ministria, por më së shumti deri në një vit nga dita e heqjes së tyre.

(3) Ministria punët e hequra në kompetencë të komunës i kryen në emër dhe në llogari të komunës.

(4) Për heqjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, njoftohet organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal dhe organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e financave.

XV. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 168

(1) Gjobë në shumë prej 50 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të shkollës fillore, nëse:

- emri i shkollës fillore është shkruar në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji,

- nuk paraqet orar për mësim plotësues dhe shtesë për çdo lëndë mësimore, në vend të dukshëm në shkollë dhe në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e tyre të internetit (neni 33 paragrafi (1)),

- nuk e organizon pranimin dhe mbrojtjen, si dhe qëndrimin e vazhduar të nxënësve (neni 40 paragrafët (2) dhe (3)),

- gabimisht janë futur të dhënat në bazën integrale të të dhënave (neni 95) dhe

- nuk lidh sigurim përkatës për përgjegjësi nga dëmi i shkaktuar (neni 161).

(2) Gjobë në shumë prej 15 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet mësimdhënësit për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje prindit, përkatësisht kujdestarit, nëse nxënësi nuk është regjistruar në afatin e përcaktuar në nenin 60 paragrafin (4) të këtij ligji.

(4) Gjobë në shumë prej 200 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prindit, përkatësisht kujdestarit për kundërvajtje nëse

nuk e plotëson obligimet për arsim dhe edukim të detyrueshëm fillor (neni 8 paragrafi (2)).

Neni 169

(1) Gjobë në shumë prej 301 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të shkollës fillore, nëse:

- puna edukativo-arsimore nuk realizohet në pajtim me nenin 9 të këtij ligji,

- organizohet shkollë rajonale pa vendim të themeluesit ose mendim pozitiv paraprak nga ministri (neni 25 paragrafi (2)),

- programin vjetor për punë nuk e dorëzon te themeluesi, Byroja dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit në afatin e përcaktuar (neni 49 paragrafët (7) dhe (10)),

- nuk realizon numrin e përgjithshëm të ditëve mësimore (neni 50 paragrafi (2)),

- organizon paralele me më pak se 20 nxënës pa marrjen e pëlqimit nga themeluesi (neni 53 paragrafi (5)),

- organizon paralele të kombinuara pa marrjen e pëlqimit nga themeluesi (neni 53 paragrafi (8)),

- shkolla fillore në kohë nuk e organizon dhe kryen regjistrimin e nxënësve (neni 60 paragrafi (1)),

- nuk i përfshin të gjithë nxënësit nga rajoni i vet duke përfshirë edhe nxënësit me pengesa (neni 63 paragrafi (2)),

- regjistron nxënës nga rajoni ose komuna tjetër pa pasur vende të lira (neni 63 paragrafi (4)),

- nuk e njofton inspektorin e autorizuar të arsimit të komunës për nxënësit të cilët nuk janë regjistruar, (neni 64 paragrafi (1)),

- nëse nuk mban e-ditar në shkollën fillore (neni 93 paragrafi (4)) dhe

- vepron në kundërshtim të nenit 108 paragrafit (1) alineve 2 dhe 3 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 51 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet mësimit nëse për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 11 të këtij neni, si dhe për kundërvajtje, nëse:

- nuk e realizon numrin vjetor dhe javor të orëve për mësim në pajtim me planin dhe programin mësimor (neni 30),

- si mësimit në klasor, përkatësisht udhëheqës i paraleles nuk e njofton prindërit respektivisht kujdestarin për sukses të nxënësit së paku dy herë për çdo gjysmë vjetor respektivisht në mbledhjen prindërore e cila mbahet tri ditë pas ditës së mbajtjes së këshillit të mësimit në klasor, në të cilën përcaktohet sukcesi dhe sjellja e nxënësve për tremujorin e parë, gjysmë vjetorin e parë, tremujorin e tretë dhe në fund të vitit mësimor përmes dorëzimit të fletëve evidentuese (neni 140 paragrafi (2)),

- si mësimit në klasor, respektivisht udhëheqës i paraleles suksesin e nxënësit nuk i ka njoftuar prindërit respektivisht kujdestarët në mbledhje të prindërve, e cila mbahet tri ditë pune pas ditës së mbajtjes së këshillit mësimor në të cilin përcaktohen notat vjetore të nxënësve. (neni 143 paragrafi (1)).

Neni 170

(1) Gjobë në shumë prej 401 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të shkollës fillore, nëse:

- në shkollën fillore kryhet diskriminim (neni 5 paragrafi (1)),
- organizohet veprimtari politike dhe fetare dhe theksohen shenja partiake dhe fetare (neni 9),
- fillon punën para përcaktimit të përmbushjes së kushteve për fillimin e punës dhe para miratimit të aktvendimi për verifikim (neni 24 paragrafi (2)),
- e ndërpret punën edukativo-arsimore në kundërshtim me nenin 50 paragrafin (6) të këtij ligji,
- kryhet maltretim trupor psikik dhe seksual dhe dënim i nxënësit dhe sjellje dhe veprim nënçmues ndaj tij (neni 65),
- nuk e paraqet dhunën, keqpërdorimin dhe anshkalimin ndaj nxënësit te organet kompetente (neni 66),
- nuk mbahet ose mbahet dhe lëshohet dokumentacion pedagogjik në kundërshtim me nenet 92 dhe 93 të këtij ligji,
- lëshon dokumente publike në kundërshtim me nenin 94 paragrafin (2) të këtij ligji,
- nuk fut të dhënat në bazën integrale të të dhënave (neni 95),
- nuk e njofton qendrën kompetente për punë sociale, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe personin përgjegjës për arsim në komunë në afat prej tri ditësh nga dita e paraqitjes së ndryshimit nga prindi përkatësisht kujdestari, në pajtim me nenin 97 paragrafi (6) të këtij ligji,
- pas evalvimit të kryer të jashtëzakonshëm integral, nuk i mënjanon shkaqet për prishjen e procesit edukativo-arsimor (neni 164 paragrafi (1)),
- nuk zbaton vetë evalvim të shkollës (neni 129) dhe
- nuk e mundëson kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë dhe mbikëqyrje inspektuese (neni 162).

(2) Gjobë në shumë prej 151 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet mësimitdhënësit të shkollës fillore për kundërvajtjen nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 5, 6, 8 dhe 11 të këtij neni.

(3) Drejtorit të shkollës fillore për veprimet nga paragrafi (1) alineja 2 të këtij neni, krahas gjobës së paraparë detyrimisht do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë me kohëzgjatje më së shumti prej një viti, duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Neni 171

(1) Organ kompetent për shqiptim të sanksioneve kundërvajtëse është gjykata kompetente.

(2) Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 172

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 168, 169 dhe 170 të këtij ligji, inspektori shtetëror i arsimit është i obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, i njëjti duhet ta nënshkruajë. Marrja e urdhërpagesës për kundërvajtje nga kryerësi i kundërvajtjes regjistrohet në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij, përcaktohet mënyra në të cilën largohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën për kundërvajtje i nënshkruan drejtori i shkollës fillore ose nga personi i autorizuar.

(5) Inspektori Shtetëror i Arsimit është i obliguar që të mbajë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara kundërvajtëse dhe rezultatin e procedurave të filluara.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat si vijojnë: emri dhe mbiemri, respektivisht emri i kryesit të kundërvajtjes, vendbanimi respektivisht vendqëndrimin, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje i cili është lëshuar dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në regjistër.

(8) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtje i përcakton ministri.

Neni 173

Mjetet nga gjobat e shqiptuara nga inspektorët shtetërorë të arsimit janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

XVI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Statusi i shkollave fillore

Neni 174

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shkollat fillore ekzistuese vazhdojnë punën e tyre dhe mbajnë statusin e fituar që kanë pasur para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Mandati i drejtorëve

Neni 175

Drejtorët e shkollave fillore të përzgjedhura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në mbarimin e kohës për të cilën ata zgjidhen.

Mandati i Këshillave të Shkollës

Neni 176

(1) Kryetari dhe anëtarët e Këshillave të Shkollës të shkollave fillore të zgjedhura respektivisht të emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre deri në mbarimin e kohës për të cilën janë zgjedhur, respektivisht të emëruar, përveç anëtarit të Këshillit të Shkollës në shkollat fillore komunale të përcaktuara nga Ministria dhe një nga anëtarët e Këshillit të Shkollës të emëruar nga themeluesi, të cilëve u përfundon mandati më së voni një muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Vendimi për ndërprerjen e mandatit të njërit prej anëtarëve të Këshillit të Shkollës të emëruar nga themeluesi, miraton themeluesi i shkollës.

Afatet për harmonizim të akteve të shkollave

Neni 177

(1) Shkolla fillore, në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, e harmonizon organizimin e saj, puna, statuti dhe aktet e tjera me këtë ligj.

(2) Deri në miratimin e akteve nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohen aktet ekzistuese të shkollës fillore.

Neni 178

Shkollat fillore ekzistuese shtetërore Enti për Rehabilitim të Fëmijëve me Dëgjim të Dëmtuar "Koço Racin" - Manastir, Shkolla e Posaçme Fillore "Idnina" - Shkup, Shkolla e Posaçme për Arsim Fillor të Fëmijëve me Pengsa në Zhvillimin Psikik "Dr. Zlatan Sremec" - Shkup, Shkolla e Posaçme Fillore për nxënësit me nevoja të veçanta edukative arsimore "Shën. Kliment Ohridski" - Novo Sellë dhe Shkolla e Posaçme Fillore me konvikt të nxënësve "Maca Gjorgjieva Ovçarova"- Veles do të regjistrojnë nxënës deri në vitin akademik 2022/2023.

Neni 179

(1) Shkollat fillore ekzistuese shtetërore Enti për Rehabilitim të Fëmijëve me Dëgjim të Dëmtuar "Koço Racin" - Manastir, Shkolla e Posaçme Fillore "Idnina" - Shkup, Shkolla e Posaçme për Arsim Fillor të Fëmijëve me Pengsa në Zhvillimin Psikik "Dr. Zlatan Sremec" - Shkup, Shkolla e Posaçme Fillore për nxënësit me nevoja të veçanta edukative arsimore "Shën. Kliment Ohridski" - Novo Sellë dhe Shkolla e Posaçme Fillore me konvikt të nxënësve "Maca Gjorgjieva Ovçarova"- Veles vazhdojnë me punë si shkolla fillore me qendra të resurseve nga viti 2020/2021, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Deri në fillimin me punë të shkollave fillore me qendër burimore, punët në kompetencë të tyre, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kryejnë shkollat fillore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Paralelet e veçanta ekzistuese në shkollat fillore vazhdojnë me punë si qendra për mbështetjen e mësimi të nxënësve me aftësi të kufizuara nga viti shkollor 2020/2021, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(4) Të punësuarit me kohë të pacaktuar pune në shkolla nga paragrafi (1) i këtij neni vazhdojnë me punë në shkollat fillore me qendër resursi, e të punësuarit me kohë të pacaktuar pune në paralelet e veçanta ekzistuese në shkollat fillore në qendra për mbështetjen e mësimi të nxënësve me aftësi të kufizuara.

(5) Deri në fillimin me punë të qendrave për përkrahje të mësimi të nxënësve me pengesa, punët në kompetencë të tyre, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kryejnë shkollat fillore me paralele të posaçme nga paragrafi (3) të këtij neni.

Afate për miratimin e akteve nënligjore

Neni 180

(1) Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në miratimin e akteve të parashikuara nga ky ligj do të zbatohen aktet ekzistuese.

(3) Koncepti për arsim gjithëpërfshirës nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji do të miratohet në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

(4) Koncepti për testim shtetëror nga neni 133 paragrafi (5) të këtij ligji do të miratohet në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Procedurat e filluara

Neni 181

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojë në pajtim me Ligjin për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/2011, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18).

Afate për dispozitat që kanë zbatim të prolonguar

Neni 182

Dispozitat e nenit 13 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga dita e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Neni 183

(1) Dispozitat e nenit 53 paragrafët (4), (5) dhe (6) dhe neni 54 paragrafi (5) të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga viti shkollor 2019/2020, për gjeneratën e nxënësve që regjistrohesh në klasën e parë dhe do të vendoset në mënyrë suksesive për çdo vit akademik.

(2) Dispozita e nenit 53 paragrafi (10) të këtij ligji do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2019/2020, për klasat në periudhën e parë edukative arsimore.

(3) Dispozita e nenit 60 paragrafi (2) që ka të bëjë me kontrollet e detyrueshme oftalmologjike do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2021/2022.

Nostrifikimi dhe ekuivalenca

Neni 184

(1) Nostrifikimi, përkatësisht ekuivalenca e dëftesës e kryer në republikat dhe krahinat autonome të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë deri më 1 shtator 1991, e ka të njëjtën vlerë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Dëftesat e personave që kanë marrë arsim në ish republikat, respektivisht shtetet e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë deri më 1 shtator 1995, njihen pa kryer procedurë për njohje.

Shfuqizimi

Neni 185

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18).

Neni 186

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".